



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 497 Akti

Nr. 617 Vendimi  
Tiranë, më 27.1.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Xhensila Pine</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datën 26.1.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Antonela Prendi**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, dhe pasi shqyrtoi në seancën dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Antonela Prendi, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Antonela Prendi ushtron detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 15.6.2020 dhe do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli (kryesuese), Xhensila Pine (anëtare) dhe Olsi Komici (relator), ndërsa si vëzhgues ndërkombëtar u caktua z. Ferdinando Buatier De Mongeot.
3. Trupi gjykues, me vendimin e datës 2.7.2020, vendosi të fillojë hetimin administrativ bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Antonela Prendi për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike<sup>1</sup>, ku iu komunikua përbërja e trupit gjykues dhe iu kërkua të deklaronte nëse kishte konflikt interesi me ndonjë nga anëtarët e tij.
4. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, subjekti i rivlerësimit deklaroi në përgjigje të pyetësorit standard se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
6. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

---

<sup>1</sup>Subjekti u njoftua po në datën 2.7.2020 me anë të postës elektronike me *email*.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Antonela Prendi, si dhe njoftimin për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 23.12.2022<sup>2</sup> mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 10.1.2023. Subjekti i rivlerësimit, brenda afatit të lënë nga Komisioni, ka depozituar pranë zyrës së protokollit të Komisionit shpjegimet dhe provat përkatëse.

9. Subjekti i rivlerësimit në datën 11.1.2023 u ftua në seancën dëgjimore, e cila do të zhvillohej më 17.1.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0 (*underground*), Tiranë.

10. Seanca e planifikuar për t'u zhvilluar në datën 17.1.2023 nuk u zhvillua, për arsye objektive të një prej anëtarëve të trupit gjykues dhe në datën 23.1.2023 subjekti i rivlerësimit u rinjoftua për caktimin e seancës së re dëgjimore, e cila do mbahej më 26.1.2023, ora 10:00, po në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 26.1.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit Antonela Prendi u paraqit personalisht dhe parashtrori shpjegimet e saj dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

12. Znj. Antonela Prendi ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONII PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

---

<sup>2</sup>Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë në rrugë elektronike me *email*.

**14.** Për subjektin e rivlerësimit Antonela Prendi, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

**15.** Pavarësisht se në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, organet ndihmëse janë ato të ngarkuara me ligj për të kryer vlerësimin e kriterit të pasurisë, figurës dhe atë profesional për subjektin e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**16.** ILDKPKI-ja<sup>3</sup>, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Antonela Prendi, e cila është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2003, me nr. indeksi \*\*\*. Në përfundim të veprimeve verifikuese ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**17.** Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

**18.** Subjekti i rivlerësimit Antonela Prendi e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, datë 26.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë, shtojca 2 (deklarata *Vetting*), janë si vijojnë:

### **Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit**

**1. Kontratë sipërmarrjeje datë 5.8.2011<sup>4</sup>**, e lidhur me shoqërinë “R.” sh.a., sipërmarrësi, dhe shtetasit E. K. e Antonela Prendit, porositësit, për ndërtimin e apartamentit me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup> (15

<sup>3</sup>Raporti nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2018, i ILDKPKI-së.

<sup>4</sup>Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 5.8.2011.

m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët), i ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, për çmimin 69,690 euro, nga të cilat 35,000 euro janë paguar në momentin e lidhjes së kontratës<sup>5</sup>. Pjesa takuese: ½.

**Kontratë shitjeje me kusht, datë 12.2.2016<sup>6</sup>**, e lidhur shoqërinë “R.” sh.a. dhe blerësve E. K. e Antonela Prendi për apartamentin e porositur më parë nr. \*\*\*, k. \*\*\*, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 5.8.2011, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, i ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”. Apartamenti është hipotekuar në favor të “\*\*\*\*” sipas kontratës së hipotekimit datë 8.3.2016<sup>7</sup>, për të garantuar kthimin e kredisë së marrë pranë kësaj banke.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pagimin e çmimit 69,690 euro me burime si vijon:

- a) 35,000 euro paguar me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes datë 5.8.2011, me burim:
  - 28,000 euro marrë hua shtetasit K. P., sipas kontratës së huas datë 16.12.2011<sup>8</sup> lidhur me huamarrësin E. K.;
  - 5,000 euro marrë hua pa kontratë shkresore babait të subjektit V. P., të kthyer tërësisht në vitin 2012 nga të ardhurat e siguruar nga puna e subjektit dhe bashkëshortit E. K., një pjesë e të cilave prej 500,000 lekësh të depozituara pranë “Raiffeisen Bank” në datën 19.1.2010 dhe mbyllur depozita në datën 26.1.2012;
  - 2,000 euro kursime nga të ardhurat nga punësimi i subjektit dhe bashkëshortit E. K.
- b) 4,600 euro likuiduar shoqërisë “R.” sh.a. sipas mandatarkëtimit datë 25.7.2013, të siguruar nga të ardhurat nga punësimi të subjektit dhe bashkëshortit E. K.
- c) 3,000 euro likuiduar shoqërisë sipas mandatarkëtimit datë 9.3.2015, të siguruar nga të ardhurat nga punësimi të subjektit dhe bashkëshortit E. K.
- d) 1,090 euro vlerë e punimeve të kryera në apartament nga porositësit Antonela Prendi dhe E. K. sipas situacionit të punimeve datë 31.12.2012, të nënshkruar mes palëve. Shpenzimet e këtyre punimeve të përlllogaritura në çmimin e sendit janë të siguruar nga të ardhurat e punës së subjektit dhe bashkëshortit E. K.
- e) 1,000 euro është bërë zbritje nga shoqëria, sikurse përshkruhet në kontratë.
- f) 25,000 euro kredi bankare e marrë nga blerësit E. K. e Antonela Prendi pranë “\*\*\*\*”, sipas kontratës së kredisë datë 8.3.2016<sup>9</sup>.

## **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**1.1** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë apartament në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2011 (në vijim DIPP) me të njëjtat të dhëna si në deklaratën *Vetting*, ndërsa në

<sup>5</sup>Konfirmuar edhe me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 4.8.2011.

<sup>6</sup>Kontratë shitjeje me kusht nr. \*\*\*, datë 12.2.2016.

<sup>7</sup>Kontratë hipotekimi nr. \*\*\*, datë 8.3.2016, për të garantuar kthimin e kredisë së marrë pranë kësaj banke.

<sup>8</sup>Kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 16.12.2011.

<sup>9</sup>Kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 8.3.2016.

DIPP/2016 ka deklaruar kontratën e shitjes me kusht, datë 12.2.2016, për apartamentin e porositur me kontratën e sipërmarrjes datë 5.8.2011, duke deklaruar të njëjtat pagesa si në deklaratën *Vetting*.

**1.2** Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*, ka rezultuar se në datën 5.8.2011 është lidhur kontrata e sipërmarrjes ndërmjet sipërmarrësit, shoqëria “R.” sh.a., përfaqësuar nga aksioneri M. Gj. dhe porositës E. K. e Antonela Prendi, për ndërtimin e apartamentit nr. \*\*\*, me sip. 101 m<sup>2</sup>, k. \*\*\*, seksioni \*\*\*, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, kundrejt çmimit 69,690 euro. Në nenin 5 të kontratës është përcaktuar mënyra e pagesës si vijon: kësti i parë prej 35,000 euro do të paguhet në momentin e lidhjes së kontratës, i cili u pagua në datën 5.8.2011; kësti i dytë prej 33,690 euro do t’i paguhet porositësit në momentin e dorëzimit të apartamentit me çelësa në dorë nga sipërmarrësi dhe pranimit të tij nga porositësit; kësti i tretë prej 1,000 euro është bërë zbritje nga shtetasi M. Gj..

**1.2.1** Subjekti ka depozituar mandatar-këtimet për blerjen e apartamentit, si vijojnë: (a) mandatar-këtimi nr. \*\*\*, datë 4.8.2011, arkëtuar E. K. e Antonela Prendi shuma 35,000 euro; (b) mandatar-këtimi nr. \*\*\*, datë 4.8.2011, arkëtuar E. K. e Antonela Prendi shuma 35,000 euro “likuidim p. “\*\*\*\*” (kësti i parë)”; (c) mandatar-këtimi nr. \*\*\*, datë 25.7.2013, arkëtuar E. K. 4,600 euro; (ç) mandatar-këtimi nr. \*\*\*, datë 9.3.2015, arkëtuar E. K. shuma 3,000 euro.

**1.2.2** Është depozituar gjithashtu edhe kontrata e shitjes me kusht e apartamentit, datë 12.2.2016, me shitës shoqëria “R.” sh.a. dhe blerës Antonela Prendi e E. K. Çmimi i shitjes së kësaj pasurie është 69,690 euro dhe do të paguhet sipas përcaktimeve në kontratë<sup>10</sup>. Po kështu edhe një “situacion” të punimeve të bëra deri në datën 31.12.2012 nga porositësi E. K., në total në shumën 1,089.63 euro, i cili është nënshkruar nga porositësi dhe nga inxhinieri i shoqërisë “R.” sh.a. dhe ortaku i vetëm M. Gj.. Pas kontratës së shitjes është lëshuar certifikata e pronësisë për apartamentin me sip. 86 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, në pronësi të shtetasve E. K. e Antonela Prendi, me pjesë takuese ½ secili.

**1.3** Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)<sup>11</sup> konfirmon abonentët E. K. dhe Antonela Prendi<sup>12</sup> në këtë adresë, ndërkohë që Ujës-jellës Kanalizime Tiranë (UKT)<sup>13</sup> nuk konfirmon kontrata të lidhura me ta.

**1.4** Subjekti i rivlerësimit, kur është në pyetur në ILDKPKI në vitin 2014<sup>14</sup>, ka deklaruar se *apartamenti është dorëzuar nga sipërmarrësi “R.” me përfundimin e ndërtimit në datën 12.12.2012 dhe se nuk është mbajtur procesverbal dorëzimi. Referuar kontratës së sipërmarrjes*

---

<sup>10</sup>Shuma 35,000 euro likuiduar sipas mandatar-këtitimit lëshuar nga shitësi në datën 4.8.2011; shuma 4,600 euro, sipas mandatar-këtitimit datë 25.7.2013; shuma 3,000 euro, sipas mandatar-këtitimit datë 9.3.2015; shuma 1,090 euro likuiduar nëpërmjet pagesave të punimeve të kryera sipas situacionit të punimeve të datës 31.12.2012, nënshkruar nga shitësi dhe blerësi; shuma 1,000 euro është bërë zbritje nga shitësi; kësti i parë prej 44,690 euro është likuiduar nga pala blerëse sipas përcaktimeve të bëra në kontratën e porosisë të datës 5.8.2011; kësti i dytë prej 25,000 euro do të paguhet nëpërmjet transfertës bankare të kryer në llogarinë e palës blerëse në “\*\*\*\*” menjëherë pas lëvrimit në favor të blerësve të kësaj shume në formën e kredisë bankare. Palët bien dakord që apartamenti, objekt i kësaj kontrate, të kalojë në pronësi të palës blerëse menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe të bllokohet në favor të palës shitëse për shumën 25,000 euro deri në momentin e pagesës së kështit të dytë nga pala blerëse.

<sup>11</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, e FSHU-së.

<sup>12</sup>Me kontratën nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, kabina “\*\*\*\*”, Tiranë.

<sup>13</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, e UKT-së.

<sup>14</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2021, e ILDKPKI-së, e cila ka të bashkëngjitur edhe dokumentacionin përkatës.

*pagesa e kështit të dytë të çmimit do të realizohej me marrjen në dorëzim të apartamentit. Pagesa e diferencës së mbetur do të mundësohej vetëm përmes marrjes së një kredie... Apartamenti ku banojnë nuk është ende i regjistruar për shkak procedurash të ndërtuesit. Në këto kushte kanë rënë dakord me sipërmarrësin që prej datës 6.3.2013 që likuidimi i kështit përfundimtar të kryhet përmes kredisë që do të merret pas regjistrimit të apartamentit.*

**1.4.1** Subjekti ka depozituar edhe aktmarrëveshjen datë 6.3.2013 lidhur me shoqërinë “R.” sh.a. ndërmjet administratorit M. Gj. dhe bashkëshortit E. K., ku palët bien dakord që likuidimi i kështit përfundimtar për blerjen e apartamentit të kryhet me kredi në momentin e daljes së hipotekës.

**1.5** Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tirana-Veri<sup>15</sup> (në vijim ASHK) konfirmon apartamentin e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Antonela Prendi e E. K. sipas kartelës së pasurisë, me çmimin 69,690 euro, ku rezulton i depozituar i njëjti dokumentacion me atë të depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*.

**1.6** Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 86 m<sup>2</sup>, krahasuar me çmimin e referencës sipas EKB-së, bazuar në udhëzimin e vitit 2011<sup>16</sup>, i cili përcakton të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2011, ku për zonën 9/2<sup>17</sup> përcakton çmimin 106,500 lekë/m<sup>2</sup>. Është llogaritur sipërfaqja 86 m<sup>2</sup> x 106,500 lekë = 9,159,000 lekë ose 65,455 euro<sup>18</sup>, ndërkohë që çmimi i blerjes së apartamentit është 69,690 euro, Komisioni vëren se ka një diferencë ndërmjet dy çmimeve, e cila konsiderohet e papërfillshme.

**1.7** Në pyetësin nr. 1 subjekti ka shpjeguar se ka banuar me qira për periudhën 2004 – 2012 në apartamentin e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, emri i së cilës ka pësuar ndryshime. Për këtë deklarament subjekti ka depozituar kontratë qiraje datë 29.4.2005, me qiradhënësin I. H. dhe qiramarrësin E. K., për apartamentin 1+1<sup>19</sup>, me afat 4-mujor, me çmim 25,000 lekë/muaj.

**1.7.1** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shtetasve I. dhe F. H. (qiradhënësit)<sup>20</sup> dhe nga verifikimi nuk rezultoi një situatë e tillë.

**1.8** Shoqëria “R.” sh.a., me shkresën datë 20.10.2022, ka konfirmuar kontratën e sipërmarrjes datë 5.8.2011 lidhur me shtetasit E. K. dhe Antonela Prendi për apartamentin me sip. 86 m<sup>2</sup>, me vlerë 69,690 euro, si dhe kontratën e shitjes me kusht datë 12.2.2016, po me shtetasit e lartpërmendur. Pala blerëse e ka shlyer të gjithë vlerën e apartamentit dhe nuk ka detyrime të pashlyera ndaj shoqërisë.

Bashkëlidhur shoqëria ka depozituar dy kontratat e sipërmarrjes dhe atë të shitjes me kusht, situacionin e punimeve për t’u zbritur në vlerën 1,089.63 euro, mandatarkëtimet sipas pagesave të porositësve, lëshuar nga shoqëria “R.” sh.a.; (a) nr. \*\*\*, datë 4.8.2011, shuma 35,000 euro; (b) nr. \*\*\*, datë 25.7.2013, shuma 4,600 euro; (c) nr. \*\*\*, datë 9.3.2015, shuma 3,000 euro; (ç)

<sup>15</sup>Aplikimi *online* i Komisionit në sistemin e ASHK-së për institucionet, me datë 25.10.2022.

<sup>16</sup>Udhëzim nr. \*\*\*, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2011”.

<sup>17</sup>Zona 9/2 përfshin zonën e stacionit të trenit, arkiva, ZVRPP, Politeknikumi.

<sup>18</sup>Referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, ku në datën 5.8.2011, 1 euro = 139.93 lekë.

<sup>19</sup>Subjekti ka depozituar kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 23.1.2000, me porositësin F. e I. H. dhe sipërmarrësin shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për ndërtimin e apartamentit në fjalë me adresë: rruga “\*\*\*\*”, Tiranë.

<sup>20</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

mandatpagesë datë 21.3.2016, lëshuar nga “\*\*\*”, transferuar nga Antonela Prendi shuma 3,465,000 lekë për shoqërinë “R.” sh.a.

**1.9** Komisioni ka konstatuar se në dokumentacionin e depozituar për pagesat e kësteve të apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dy mandatpagesa në shumën 35,000 euro me të njëjtën datë 4.11.2011, por me numër serial të ndryshëm dhe për këtë qëllim i ka kërkuar shpjegime subjektit me pyetësonin nr. 2.

**1.9.1** Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime në lidhje me këtë problematikë, të njëjta me ato në deklaratën noteriale të datës<sup>21</sup> 28.10.2022, me deklaruës shoqërinë “R.” sh.a., të përfaqësuar nga administratori F. M., i cili, ndër të tjera, ka shpjeguar: *“[...] Pala blerëse është pajisur me dy mandatarkëtime në vlerë dhe datë të njëjtë, por numër serial të ndryshëm nga njëri-tjetri. [...] për shkak të mënyrës së organizimit të brendshëm të asaj kohe pagesat e marra nga arka dorëzoheshin pranë departamentit të financës me një mandat tjetër arkëtimi. Mandati nr. \*\*\*, datë 4.8.2011, ka shërbyer vetëm për këtë qëllim, jo për të pasqyruar një arkëtim të dytë. Sqarojmë se sektori i financës pranë shoqërisë ‘R.’ sh.a. organizohej si vijon: arka pranë sektorit të ndërtimit arkëtonte pagesat që vinin nga shitjet e apartamenteve, duke pajisur klientët me një mandatpagesë që vërtetonte likuidimin e kryer. Për të bërë kontabilizimin e këtyre pagesave lëshohej edhe një mandat i dytë me të njëjtën datë dhe vlerë nga arka e sektorit të ndërtimit për në arkën qendrore të shoqërisë”*.

**1.10** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “R.” sh.a., si dhe administratorit të saj M. Gj. dhe për këtë qëllim ka administruar përgjigjen në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>22</sup>, e cila konfirmon se kjo shoqëri dhe administratori/ortaku M. Gj. kanë pasur procese gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por çështjet janë gjykuar nga gjyqtarë të tjerë.

**1.10.1** Nga hetimi ka rezultuar vendimi nr. \*\*\*, datë 23.2.2006, pushim gjykimi i çështjes civile me palë paditëse M. Gj., i paditur Dega e Policisë Elektrike Tiranë, me objekt “shfuqizim akti administrativ”, ku subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarës së çështjes, duke qenë se paditësi M. Gj. nuk është paraqitur në datën e gjykimit, ka vendosur pushimin e gjykimit.

Ka rezultuar se nga subjekti Antonela Prendi është marrë në shqyrtim për t’u gjykuar dhe është përfunduar çështja me palë paditëse shtetasin M. Gj. shumë kohë më përpara se subjekti të hynte në marrëdhënie interesi me shoqërinë/ortakun në fjalë dhe në këtë rast Komisioni konkludon se nuk jemi përpara një situatë konflikti interesi.

**Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të shumës 69,690 euro të blerjes së apartamentit, e cila përbëhet nga 35,000 euro, 4600 euro, 3000 euro, 1090 euro, 1000 euro dhe 25,000 euro kredi.**

**1.11** Fillimisht është analizuar burimi i pagesës prej 35,000 euro me datë 5.8.2011, e cila përbëhet nga 28,000 euro, 5,000 euro dhe 2,000 euro, si vijon:

<sup>21</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 28.10.2022, e administratorit të shoqërisë “R.” sh.a.

<sup>22</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



**1.11.1** Shuma 28,000 euro, marrë hua shtetasit K. P. sipas kontratës së huas datë 16.12.2011<sup>23</sup>, lidhur me huamarrësin E. K.

**1.11.2** Kontrata e huas është deklaruar nga subjekti në DIPP/2011, kohë kur është marrë kjo hua, si dhe në deklaratën *Vetting*. Sipas kësaj kontrate, huadhënësi K. P. i jep huamarrësit E. K. shumën 28,000 euro pa kamatë mujore dhe pa afat të përcaktuar kohor. Në nenin 1 të kontratës përcaktohet se huamarrësi e ka marrë këtë shumë në gusht të vitit 2011 për nevoja familjare (blerje banese). Në nenin 2 deklarohet se huadhënësi këtë shumë e ka siguruar nga të ardhurat e siguruara nga puna në emigracion, kursimet e veta dhe të familjes së tij. Në nenin 3 përcaktohet se huaja është dhënë *cash* jashtë zyrës noteriale, ndërsa në pikën 3.2 parashikohet se shuma totale do të shlyhet me këste mujore dhe do të konfirmohen me nënshkrimet e ndërsjella.

**1.11.3** Në deklaratën noteriale datë 11.11.2014<sup>24</sup>, shtetasi K. P., ndër të tjera, ka deklaruar se shuma 28,000 euro është siguruar nga kursimet e tij familjare (një pjesë prej punës në emigracion, për të cilën nuk disponon dokumentacion dhe pjesa tjetër nga vitet e punës në Shqipëri)<sup>25</sup>. Subjekti ka deklaruar në DIPP/2016 dhe në pyetësorin standard shlyerje pjesore të huas.

**1.11.4** Për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 28,000 euro dhënë hua nga shtetasi K. P., subjekti, me pyetësorin nr. 1, ka depozituar dokumentacionin në lidhje me punësimin e xhaxhait K. P. dhe bashkëshortes së tij M. P.<sup>26</sup>, duke shpjeguar se kjo shumë ka si burim: (a) kursimet e familjes nga marrëdhëniet e punësimit ndër vite; si dhe (b) të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e huadhënësit K. P. nga aktiviteti i tregtimit të produkteve të prodhuara prej saj gjatë periudhës korrik 1995 – dhjetor 2004 dhe se këto të ardhura, në pjesën dërrmuese të tyre, janë mbajtur *cash* në banesë prej tyre, ndërsa një pjesë në llogarinë e hapur pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, konkretisht depozitat 700,000 lekë dhe 350,000 lekë të tërhequra përkatësisht në datat 17.10.2008 dhe 22.12.2008, duke gjeneruar edhe interesa në shumën totale prej 239,346 lekësh.

<sup>23</sup>Kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 16.12.2011.

<sup>24</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 11.11.2014, e huadhënësit K. P.

<sup>25</sup>Për detaje shihni deklaratën noteriale në dosjen e hetimit.

<sup>26</sup>Për shtetasin M. P. janë depozituar: (i) librezë pune; (ii) vërtetim<sup>26</sup> mbi bazën e vlerësueshme i Arkivit Qendror për periudhën korrik 2007 – dhjetor 2012; (iii) vërtetim<sup>26</sup> i DRSSH-së Berat për periudhën 20.11.2014 – 31.7.2020, pension pleqërie në shumën 1,121,905 lekë; (iv) shkresë kthim përgjigjeje<sup>26</sup> e DRSSH-së Berat për dosjen e pensionit me nr. \*\*\* të znj. M. P., bashkëlidhur së cilës, ndër të tjera, janë: (1) vërtetim i DR të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Berat për periudhën korrik 1994 – qershor 1995 (asistencë) në shumën 21,120 lekë; (2) vërtetim i DR të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë për vitin 1996 (asistencë) në shumën 26,200 lekë; (3) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* për periudhën 1.6.2007 – 31.8.2011 në shumën 756,508 lekë; (v) për periudhën 1.7.1995 – 31.12.2004 subjekti deklaroi se ka prodhuar në kushte shtëpie dhe më pas tregtuar produkte të ëmbla në subjekte të ndryshme tregtare. Për shtetasin K. P. ka depozituar: (i) vërtetim<sup>26</sup> i “\*\*\*\*” për periudhën 2003 – 2006 në shumën *neto* 1,516,203 lekë; (ii) vërtetimet<sup>26</sup> e DR Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj se shtetasi K. P. ka qenë i punësuar në shoqërinë “\*\*\*\*” për periudhën dhjetor 2011 – maj 2013, në shoqërinë “\*\*\*\*” për periudhën korrik 2013 – mars 2014, si dhe në shoqërinë “\*\*\*\*” për periudhën janar 2015 – tetor 2015 dhe ka paguar kontributet e sigurimeve dhe tatimin; (iii) librezë pune për shtetasin K. P.; (iv) vërtetim punësimi i OSHEE-së për periudhën tetor 2015 – qershor 2020; (v) llogari page në “Intesa Sanpaolo Bank” të shtetasit K. P., për vitet 2007 – 2015; (vi) vërtetim<sup>26</sup> mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto*, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë për periudhën maj 2006 – shkurt 2008 në shumën *bruto* 266,000 lekë; (vii) vërtetim page nga “\*\*\*\*”, për periudhën maj 2008 – shkurt 2011 në shumën *neto* 877,313 lekë dhe për periudhën qershor 2011 – maj 2013<sup>26</sup> në shumën *neto* 600,282 lekë; (viii) vërtetim<sup>26</sup> i shoqërisë “\*\*\*\*” për periudhën korrik 2013 – mars 2014 në shumën *neto* 312,813 lekë; (ix) vërtetim<sup>26</sup> i DRT-së Tiranë i ekstraktit historik të punonjësit për periudhën dhjetor 2011 – qershor 2020; (x) vërtetim<sup>26</sup> page për periudhën gusht 1996 – mars 2002 në shumën 578,569 lekë<sup>26</sup>.

**1.11.5** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me shpjegimet e dhëna për burimin e krijimit të shumës 28,000 euro, ka depozituar dokumentacion provues ligjor përkatës për aktivitetin e ushtruar nga bashkëshortja e xhaxhait të saj, znj. M. P.<sup>27/28</sup>.

**1.11.6** Referuar dokumentacionit të depozituar më lart, subjekti, në përfundim të shpjegimeve të saj, arsyeton se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive të parashikuara nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, duke dhënë edhe argumentet përkatëse.<sup>29</sup>

**1.11.7** Komisioni, referuar burimit të krijimit të huas së marrë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të depozituar prej saj, kreu analizën financiare të personit tjetër të lidhur K. P. për mundësinë financiare për dhënien e huas në shumën 28,000 euro në gusht të vitit 2011. Për këtë, Komisioni, deri në këtë fazë të hetimit, mori në konsideratë të ardhurat e ligjshme për të cilat u provua pagesa e tatimeve dhe shpenzimet jetike të shtetasve K. dhe M. P..

**Tabela nr. 1**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
1	Të ardhura nga V. P. 1996 - 8/2011	3,308,781
2	Të ardhura nga M. P. 1994 - 8/2011	978,828
3	Të ardhura nga emigracioni 1995 - 1996	0
	<b>Total të ardhura</b>	<b>4,287,609</b>
1	Shpenzimet jetike <sup>30</sup>	2,561,437
2	Hua e dhënë 28,000 euro, 8/2011	3,918,040
	Mundësia financiare për dhënien e huas 8/2011	<b>-2,191,868</b>

<sup>27</sup>(a) Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2022, i Bashkisë Berat, e cila konfirmon se znj. M. P. ka qenë tregtare ambulante në tregun e qytetit, lagjja “\*\*\*\*”, për periudhën 1996 – 2004 dhe ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj bashkisë; (b) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 8.11.2022, e shtetasit V. Z., i cili ka ushtruar detyrën e inspektorit në DTT, Bashkia Berat, për vitet 2001 – 2017, i cili konfirmon se znj. M. P. ka tregtuar në tregun e qytetit të Beratit gjatë viteve 2001 – 2004 dhe ka paguar rregullisht detyrimet; (c) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2022, i Bashkisë Berat, i cili konfirmon se z. V. Z. ka qenë i punësuar në Bashkinë Berat si inspektor në DTT gjatë periudhës 2001 – 2017; (ç) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 8.11.2022, e shtetasit S. D., i cili, ndër të tjera, deklaroi se ka qenë i regjistruar si person fizik tregtar në datën 19.2.1998 me NIPT \*\*\*, me aktivitet “tregtim me pakicë të artikujve të ndryshëm”, ku gjatë viteve 1998 – 2004 ka blerë në mënyrë të vazhdueshme nga shtetasja M. P. produkte të prodhuara prej saj; (d) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 8.11.2022, e shtetasit V. L., i cili, ndër të tjera, deklaroi se ka qenë i regjistruar si person fizik tregtar në datën 27.3.2000, me NIPT \*\*\*, me aktivitet “kafe”, ku gjatë viteve 2000 – 2004 ka blerë nga shtetasja M. P. produkte të prodhuara prej saj; (dh) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.8.2020, e Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) Berat, e cila pasqyrore faktin se për aktivitetin e ushtruar prej znj. M. P. si prodhuese llokmesh në librat që disponon Shërbimi i Higjienës dhe për këtë shtetase rezultoi e regjistruar një librezë shëndetësore viti 2002, datë 20.5.2002, punëtore, lagjja “\*\*\*\*”.

<sup>28</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2022 nga Shoqëritë Huamarrëse në Administrim.

<sup>29</sup>(a) Subjekti i referohet faktit që Bashkia Berat, e cila ka administruar aktivitetin tregtar në qytetin e Beratit, nuk mund të konfirmojë të ardhurat nga tregtimi i subjektit M. P. për periudhën 1996 – 2004, për arsye të diktuar nga elemente kohore dhe faktike të mënyrës së administrimit dhe dokumentimit të veprimtarisë në tregjet e lira të qytetit; (b) fakti që pushteti vendor konfirmon se znj. M. P. ka ushtruar aktivitet në mënyrë të pandërprere për një periudhë 8-vjeçare dhe se tregtarët ambulantë sipas legjisllacionit të kohës realizonin një xhiro deri në 2,000,000 lekë duhet të përlogariten të ardhura nga ky aktivitet me një marzh fitimi 40-50%, ku fitimi vjetor i realizuar ka qenë në vlera 700,000 - 800,000 lekë/vit ose 60,000 - 70,000 lekë/muaj; (c) znj. M. P. nuk ka qenë subjekti i deklaramit të pasurisë dhe as person i lidhur me subjektin e rivlerësimit gjatë viteve 1996 – 2004 e, për pasojë ajo, nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor për ruajtjen e dokumentacionit në lidhje me të ardhurat e realizuara për këto vite; (ç) Kolegji i Posaqëm i Apelit në vendimmarrjet më të fundit të tij ka orientuar praktikën në lidhje me situatat e ngjashme të mungesës dokumentare zyrtare të nivelit të të ardhurave të realizuara nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, për shkaqe objektive, duke konkluduar përfshirjen në analizën financiare të një niveli logjik ekonomik të ardhurash, duke marrë në konsideratë kohën dhe llojin e aktivitetit të ushtruar<sup>29</sup>. Gjithashtu, subjekti i referohet edhe vendimit të Komisionit nr. \*\*\*, datë 28.2.2020, të subjektit A. V., i cili ka marrë formë të prerë.

<sup>30</sup>Për periudhën 2000 – 2005 shpenzimet jetike janë marrë vetëm për një individ, meqenëse edhe të ardhurat për këtë periudhë janë marrë për një individ. Për periudhën para vitit 1999 shpenzimet janë llogaritur sa 66% e të ardhurave familjare, sipas vendimit nr. 18/2019 (JR), datë 26.7.2019.

Nga analiza financiare e mësipërme rezultoi se personi i lidhur K. P. dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 28,000 euro në gusht të vitit 2011, pasi rezultoi me balancë negative në shumën -2,191,868 lekë.

#### **1.11.8 Komisioni ka analizuar gjithashtu shumën 5,000 euro, marrë hua babait të subjektit V. P.**

**1.11.8.1** Subjekti e ka deklaruar huan e marrë babait të saj edhe në DIPP/2012, pa kontratë, me qëllim blerje apartamenti<sup>31</sup>. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se kjo shumë është kthyer tërësisht në vitin 2012 nga të ardhurat e siguruar nga puna e subjektit dhe e bashkëshortit E. K.

**1.11.8.2** Subjekti i rivlerësimit, për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 5,000 euro dhënë hua nga babai i saj, ka depozituar dokumentacionin provues të të ardhurave të përfituara nga punësimi ndër vite i shtetasve V. dhe S. P. (libreza pune, vërtetime të DRSSH-së për punësimet ndër vite etj.)<sup>32</sup>, dhe vërtetim datë 13.7.2020 nga Bashkia Berat.

**1.11.8.3** Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 3, i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion provues ligjor për të ardhurat e përfituara nga babai i saj V. P. për huan e dhënë subjektit në shumën 5,000 euro për periudhën 1997 – 2011.

**1.11.8.4** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të këtij pyetësi, ka depozituar si dokument mandatarëkëtim të vitit 2009, ku shtetasi V. P. ka paguar ndaj bashkisë detyrimin 8,400 lekë<sup>33</sup>. Për vitin 2010 nga shtetasi V. P. kanë disponuar edhe dy fatura për arkëtim, ku është paguar tatimi i thjeshtuar 6-mujor në shumën 2,500 lekë. Në faturë përfshihen edhe pagesat e tarifave/taksat e tjera paguar Bashkisë Berat<sup>34</sup>. Subjekti ka depozituar disa kontrata qiraje të lidhura me Bashkinë Berat për njësinë e shërbimit ku aktualisht ushtron aktivitetin personi tjetër i lidhur V. P., së bashku me mandatarëkëtimet për pagesën e detyrimeve të qirasë ndaj Bashkisë<sup>35</sup>.

**1.11.8.5** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar në mbështetje të shpjegimeve, vlerësoi se në tërësi të provave dhe shpjegimeve të subjektit, duke mbajtur në konsideratë se vetëm dy faturat për arkëtim, ku provohet se ishte paguar tatimi i thjeshtuar 6-mujor nga babai i saj, provojnë me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të babait të subjektit që me të ardhura të ligjshme të krijojnë shumën 5,000 euro, dhënë hua subjektit të rivlerësimit, konfirmuar edhe me veprimin bankar të tërheqjes së kësaj shume në datën 4.8.2011.

---

<sup>31</sup>Hua e marrë në vitin 2011 shtetasit V. P., pa kontratë shkresore, në shumën 5,000 euro me qëllim blerjen e një apartamenti banimi. Shlyer gjatë vitit 2012 e gjithë shuma. Burimi i pagesës: vlera 549,000 lekë e tërhequr nga "Raiffeisen Bank" dhe diferenca prej 151,000 lekësh kursime vjetore nga të ardhurat vjetore. Shlyerja është bërë dorazi pa formë shkresore për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare.

<sup>32</sup>Për detaje shihni dokumentacionin provues të depozituar nga subjekti me pyetësorin nr. 1. Të dhënat që përmbajnë këto dokumente janë pasqyruar nga Komisioni në analizën financiare.

<sup>33</sup>Mandatarëkëtim nr. \*\*\*, datë 24.7.2009, arkëtuar nga shtetasi V. P. për Bashkinë Berat, tregu industrial 8,400 lekë.

<sup>34</sup>Fatura për arkëtim nr. \*\*\*, datë 20.6.2010, lëshuar nga Bashkia Berat për shtetasin V. P., tatim i thjeshtuar 2,500 lekë, taksë tregu -5,346 lekë, totali 7,846 lekë; faturë për arkëtim nr. \*\*\*, datë 16.4.2010, lëshuar nga Bashkia Berat për shtetasin V. P., tatim i thjeshtuar 6-mujori 2,500 lekë, taksë zënie vendi -5,346 lekë, tarifë gjelbërimi 15 lekë, tarifë pastrimi 445 lekë, totali 8,466 lekë.

<sup>35</sup>Për detaje shihni kontratat e qirasë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit bashkë me pyetësorin nr. 3.

**1.11.8.6** Në lidhje me kthimin e huas në shumën 5,000 euro të marrë në gusht të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit deklaroi në DIPP/2012: “Burimi i pagesës. Vlera prej 549,000 lekësh e tërhequr nga ‘Raiffeisen Bank’ dhe diferenca prej 151,000 lekësh kursime vjetore nga të ardhurat vjetore”.

**1.11.8.7** “Raiffeisen Bank” konfirmon tërheqjen e depozitës dhe interesave të saj në datën 26.1.2012, përkatësisht në shumat 500,000 lekë dhe 54,900 lekë. Burimi i krijimit të depozitës është trajtuar gjerësisht në pikën 2. Në lidhje me shumën 151,000 lekë që ka si burim të ardhurat vjetore, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit për vitin 2012 ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe krijuar pasuritë, pasi rezultoi me balancë pozitive.

**1.11.9 Komisioni ka analizuar shumën 2,000 euro kursime nga të ardhurat e siguruara nga marrëdhënia e punës së subjektit dhe bashkëshortit E. K.**

**1.11.9.1** Në DIPP/2010, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar kursime cash. Të ardhurat e përdorura për krijimin e shumës 2,000 euro i përkasin të ardhurave të krijuara në vitin 2011 deri në momentin e kryerjes së pagesës datë 4.8.2011.

**1.11.9.2** Komisioni për të analizuar mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortit të saj për të krijuar 2,000 euro, mori në konsideratë të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe likuiditetet deri në datë 4.8.2011 dhe kreu analizën financiare si vijon:

**Tabela nr. 2**

	<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2011 – 4.8.2011</b>
<b>Nr.</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>845,832</b>
1	Të ardhura nga paga e subjektit	552,161
2	Të ardhura nga paga e bashkëshortit	293,671
	<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
	<b>Shpenzime</b>	<b>533,240</b>
1	Shpenzime jetike	273,240
2	Shpenzime udhëtimi	-
3	Shpenzime mobilimi	60,000
4	Shpenzime qiraje	200,000
	<b>Pasuri</b>	<b>297,367</b>
1	Ndryshim likuiditeti (gjendje likuiditeti në fund - gjendje likuiditeti në fillim)	17,507
2	Pagesë 2,000 euro, datë 4.8.2011 (pjesë e pagesës 35,000)	279,860
	<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>15,225</b>

Në përfundim të hetimit rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e shumës 2,000 euro, si pjesë e pagesës 35,000 euro të kryer në datën 4.8.2011.

**1.12 Komisioni ka analizuar pagesat prej 4,600 euro dhe 3,000 euro të deklaruara nga subjekti, me burim nga të ardhurat e punës së subjektit dhe bashkëshortit E. K.**

**1.12.1** Në deklaratën Vetting subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: shuma 4,600 euro likuiduar shoqërisë “R.” sh.a. në datën 25.7.2013, sipas mandatarkëtimit të kësaj date; dhe shuma 3,000 euro

likuiduar shoqërisë “R.” sh.a. në datën 9.3.2015, sipas mandatarkëtimit të kësaj date, të siguruara nga të ardhurat e punës së subjektit dhe bashkëshortit E. K.

**1.12.2** Këto pagesa janë deklaruar nga subjekti edhe në deklaratat periodike dhe konkretisht në DIPP/2013 pagesa 4,600 euro dhe në vitin 2015 pagesa 3,000 euro, me burim nga të ardhurat e punës së subjektit dhe bashkëshortit E. K.

**1.12.3** Nga verifikimi i DIPP/2012 rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar kursime *cash* në datën 31.12.2012. Në këto kushte të ardhurat e përdorura për pagesën e shumës 4,600 euro në datën 25.7.2013 janë konsideruar të krijuara nga të ardhurat e vitit 2013. Komisioni kreu analizën financiare deri në datën e kryerjes së pagesës, si vijon:

**Tabela nr. 3**

	<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2013 – 25.7.2013</b>
<b>Nr.</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>769,063</b>
1	Të ardhura nga leja e lindjes	114,520
2	Të ardhura nga paga e subjektit	346,133
3	Të ardhura nga paga e bashkëshortit	308,410
	<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
	<b>Shpenzime</b>	<b>504,056</b>
1	Shpenzime jetike	329,056
2	Shpenzime qiraje	175,000
	<b>Pasuri</b>	<b>590,184</b>
1	Ndryshim likuiditeti ( <i>gjendje likuiditeti në fund - gjendje likuiditeti në fillim</i> )	(54,736)
2	Pagesë 4,600 euro, datë 25.7.2013	644,920
	<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-325,324</b>

Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shumën 4,600 për pagesën e datës 25.7.2013.

**1.12.4** Nga verifikimi i DIPP/2014 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Kursimi nga të ardhurat vjetore të siguruara nga puna e deklaruesit dhe bashkëshortit për vitin 2014. 500,000 lekë gjendje cash*”.

Referuar analizës financiare për vitin 2014<sup>36</sup>, subjekti dhe bashkëshorti i saj rezultojnë me balancë pozitive për kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, ndër të cilat edhe kursimet *cash* në shumën 500,000 lekë. Gjendja *cash* prej 500,000 lekësh e deklaruar në DIPP/2014 është e mjaftueshme për të përballuar pagesën 3,000 euro në datën 9.3.2015 ose kundërvlerën e saj prej 420,900 lekësh.

<sup>36</sup>Shihni analizën financiare për vitet 2004 – 2016.

Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur burime të ligjshme për pagesën e shumës 3,000 euro.

**1.13 Komisioni ka analizuar edhe vlerën 1,090 euro të punimeve të kryera brenda apartamentit nga porositësit Antonela Prendi dhe E. K. sipas situacionit të punimeve datë 31.12.2012, të nënshkruar mes palëve.** Shpenzimet e këtyre punimeve të përlogaritura në çmimin e sendit janë të siguruara nga të ardhurat e punës së subjektit dhe bashkëshortit të saj.

**1.13.1** Bashkë me deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar dhe një “situcion” të punimeve të bëra deri më 31.12.2012 nga porositësi E. K., në total në shumën 1,089.63 euro, i nënshkruar nga porositësi dhe nga inxhinieri i shoqërisë “R.” sh.a. dhe ortaku i vetëm M. Gj..

**1.13.2** Komisioni, sipas burimit të krijimit të deklaruar në deklaratën *Vetting* për shumën e shpenzuar me situacionin e punimeve prej 1,090 euro, për analizimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit iu referua analizës financiare të vitit 2012, në të cilën e ka përfshirë këtë shumë si shpenzim. Sipas analizës financiare të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet dhe paguar detyrimet, pasi kanë rezultuar me balancë pozitive.

**1.14 Komisioni ka analizuar shumën 1,000 euro, e cila është bërë zbritje nga vetë shoqëria “R.” sh.a., sikurse përshkruhet në kontratë.**

**1.14.1** Komisioni, me pyetësorin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë në lidhje me shumën 1,000 euro zbritje nga çmimi i blerjes nga ana e shoqërisë “R.” sh.a., të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes dhe atë të shitjes me kusht.

Subjekti ka shpjeguar se palët kontraktuese kanë pasqyruar saktësisht çmimin e sendit referuar vlerës së tij në kohën kur është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes prej 69,690 euro dhe me transparencë e korrektesë kanë evidentuar uljen në masën 1,000 euro nga ky çmimi si rezultat i negociatave.

**1.15 Komisioni ka analizuar shumën 25,000 euro marrë kredi për të paguar këstin e çmimit të blerjes së apartamentit.**

**1.15.1** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar kredinë afatgjatë dhe ka depozituar kontratën përkatëse të lidhur në datën 8.3.2016<sup>37</sup> mes “\*\*\*\*” dhe kredimarrësve Antonela Prendi dhe E. K., me qëllim blerje apartamenti, në shumën 3,475,000 lekë. Kjo kredi është deklaruar nga subjekti edhe në DIPP/2016.

**1.15.2** Gjithashtu është depozituar edhe kontrata e hipotekimit datë 8.3.2016, me hipotekues Antonela Prendi dhe E. K. dhe përfitues “\*\*\*\*”, për pasurinë apartament me sip. 86 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, sipas certifikatës së pronësisë datë 16.2.2016. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të shitësit, shoqëria “R.” sh.a., deri në likuidimin total të çmimit të shitjes së përcaktuar në kontratën e shitjes me kusht.

---

<sup>37</sup>Kontratë kredie bankare nr. \*\*\*, datë 8.3.2016.

**1.15.3** OTP Bank<sup>38</sup> konfirmon veprimin e datës 17.3.2016 “disbursim fondesh për kredinë në shumën 3,475,000 lekë” dhe veprimin e datës 21.3.2016 “pagesë në shumën 3,465,000 lekë<sup>39</sup> në favor të ‘R.’ sh.a. pagesë përfundimtare sipas kontratës së shitjes me kusht nr. \*\*\*, datë 12.2.2016, nga Antonela Prendi dhe E. K.”.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika në lidhje me deklarinimin dhe disbursimin e fondeve të përfituara nga kredia e përdorur si burim për blerje apartamenti.

**1.16** Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka konstatuar:

**i. Për sa i përket deklarinimit dhe çmimit të apartamentit ka konstatuar se:** (a) deri në fazën e rezultateve të hetimit nga Komisioni janë marrë në konsideratë se dy mandatet prej 35,000 euro janë pjesë përbërëse e çmimit total të apartamentit; (b) subjekti iu kërkua që të heqë çdo dyshim se apartamenti nuk është blerë më shtrenjtë se vlera që pasqyron kontrata, duke depozituar kontrata të ngjashme të lidhura me shoqërinë “R.” sh.a.; (c) subjekti duhet të provojë në mënyrë shteruese se vlera reale e apartamentit është 69,690 euro dhe se shuma 35,000 euro nuk është pagesë e subjektit të rivlerësimit për ndonjë apartament të përfituar nga të afërmit e saj apo të bashkëshortit; (ç) subjekti i rivlerësimit të japë shpjegime shteruese për zbritjen e çmimit 1,000 euro nga ndërtuesi.

**ii. Për sa i përket burimit të krijimit të apartamentit ka konstatuar se:** (a) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk provojnë me burime të ligjshme huan e marrë në shumën 28,000 euro nga shtetasi K. P., pasi rezultojnë me mungesë burimesh në shumën 2,191,868 lekë; (b) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk provojnë me burime të ligjshme pagesën 4,600 euro në datën 25.7.2013, pasi rezultojnë me mungesë burimesh në shumën 325,324 lekë; (c) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk provojnë me burime të ligjshme pagesën 35,000 euro ose 4,897,550 lekë në datën 4.8.2011 (mandati i dytë). Pra, në total, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj rezultojnë me mungesë burimesh në shumën 7,414,742 lekë për blerjen e apartamentit.

Për konstatimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.16.1** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore në lidhje me deklarinimin e apartamentit dhe çmimit të blerjes së tij, ka shpjeguar se:

**a)** Për sa i përket ekzistencës së dy mandateve prej 35,000 euro të depozituara prej subjektit bashkë me deklaratën *Vetting*, ka dhënë të njëjtat shpjegime me ato të dhëna në pyetësorin nr. 2<sup>40</sup> (pasqyruar nga Komisioni në pikat 1.9 dhe 1.9.1 të vendimit). Subjekti thekson se fakti i lëshimit

<sup>38</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021.

<sup>39</sup>E konvertuar me kursin e këmbimit të euros prej 139.39 lekësh të Bankës së Shqipërisë në datën 21.3.2016 në shumën 25,038 euro.

<sup>40</sup>Për detaje shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosje.

të dy mandateve pasqyrohet edhe në kartelat e dy arkave të shoqërisë. Subjekti depozitoi si provë kartelat e dy arkave të shoqërisë “R.” sh.a., ku evidentohen veprimet përkatëse kontabël.

**b)** Në lidhje me çmimin e apartamentit prej 69,690 euro, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës 14 kontrata sipërmarrjeje (të shoqëruara me kontratat përkatëse të shitjes)<sup>41</sup> të lidhura në periudhën 2011 – 2013 nga shoqëria “R.” sh.a. me shtetas të tjerë në të njëjtën zonë, nga ku ka rezultuar se çmimi i pasqyruar në këto kontrata me shpërfaqe ndërtimi të përafërta me apartamentin e subjektit pasqyronin çmime të përafërta me çmimin që subjekti ka përfituar apartamentin nga kjo shoqëri). Subjekti ka depozituar gjithashtu librezat e energjisë elektrike dhe të ujit për apartamentin në fjalë.

**c)** Në lidhje me barrën e provës nëse persona të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin kanë lidhur kontrata për apartamente me shoqërinë “R.” sh.a., subjekti depozitoi deklaratën noteriale datë 23.12.2022<sup>42</sup> të kësaj shoqërie, e cila konfirmoi se subjekti, bashkëshorti i saj dhe personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur (V. P., M. L., V. K., I. P., K. P., M. P.) nuk kanë porositur apo nuk kanë blerë pasuri tjetër të paluajtshme nga shoqëria “R.” sh.a. Subjekti ka depozituar gjithashtu konfirmimin nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana-Veri<sup>43</sup> që shtetasit e lartpërmendur nuk kanë të regjistruar pasuri në emrin e tyre.

**ç)** Në lidhje me shumën 1,000 euro zbritje e ndërtuesit nga çmimi 69,690 euro, subjekti, ashtu si edhe në pyetësonin nr. 2, ka shpjeguar se kjo zbritje është rezultat i negociatave me ndërtuesin, veprim ky që njihet edhe nga Kodi Civil. Kjo zbritje është bërë në transparencë të plotë, duke u pasqyruar edhe në kontratën e porosisë dhe të shitjes.

**1.16.2** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, ndër të tjera, ka shpjeguar se:

**i)** Në lidhje me huan e marrë xhaxhait K. P. në shumën 28,000 euro, ku Komisioni konstatoi mungesë burimesh të ligjshme nga xhaxhai në shumën 2,191,868 lekë, subjekti u ka qëndruar

<sup>41</sup>1) Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 12.2.2013, lidhur mes shoqërisë “R.” sh.a. dhe porositësve E. M. dhe E. K., me objekt “porositjen e apartamentit me sipërfaqe totale 106 m<sup>2</sup> kundrejt çmimit 70,000 euro, që i korrespondon çmimi 660 euro/m<sup>2</sup>”; 2) kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 7.9.2016, lidhur me porositësin M. K., për apartamentin me sipërfaqe totale 107 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 74,900 euro, që i korrespondon çmimi 700 euro/m<sup>2</sup>; 3) kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 9.1.2013, me porositësit A. Z. dhe A. Z. për apartamentin me sipërfaqe totale 77 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 53,900 euro, që i korrespondon çmimi 700 euro/m<sup>2</sup>; 4) kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 14.8.2012, lidhur me porositësen L. C. për apartamentin me sipërfaqe totale 90 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 63,000 euro, që i korrespondon çmimi 700 euro/m<sup>2</sup>; 5) kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 20.2.2012, me porositësit G. B. dhe A. B., për apartamentin me sip. 100 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 72,000 euro, që i korrespondon çmimi 720 euro/m<sup>2</sup>; 6) kontratë porosie nr. \*\*\* rep., datë 15.2.2016, me porositësin H. S., për apartamentin me sip. 90 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 63,000 euro, që i korrespondon çmimi 700 euro/m<sup>2</sup>; 7) kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 26.5.2014, me porositësin K. H. për apartamentin me sip. 79.1 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 51,400 euro, që i korrespondon çmimi 650 euro/m<sup>2</sup>; 8) kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 30.12.2013, me porositësin B. Sh., për apartamentin me sip. 107 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 65,000 euro, që i korrespondon çmimi 608 euro/m<sup>2</sup>; 9) kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 21.1.2013, me porositësit S. S. dhe D. S., për apartamentin me sip. 106 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 69,960 euro, që i korrespondon çmimi 660 euro/m<sup>2</sup>; 10) kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 2.12.2011, me porositësin M. L., për apartamentin me sip. 93 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 62,310 euro, që i korrespondon çmimi 670 euro/m<sup>2</sup>; 11) kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 8.7.2013, me porositësit R. L. dhe F. L., për apartamentin me sip. 100 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 65,000 euro, që i korrespondon çmimi 650 euro/m<sup>2</sup>; 12) kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 1.12.2011, me porositësin B. Gj., për apartamentin me sip. 90.7 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 62,583 euro, që i korrespondon çmimi 690 euro/m<sup>2</sup>; 13) kontratë datë 11.3.2011, me porositësit D. K. dhe L. K., për apartamentin me sip. 98 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 68,600 euro, që i korrespondon çmimi 700 euro/m<sup>2</sup>; 14) kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 31.01.2012, me porositësit I. N. dhe K. N., për apartamentin me sip. 101 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 66,000 euro, që i korrespondon çmimi 654 euro/m<sup>2</sup>.

<sup>42</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 23.12.2022.

<sup>43</sup>Vërtetimet nr. \*\*\*, nr. \*\*\*, nr. \*\*\*, nr. \*\*\*, nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2022.



shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion gjatë hetimit (të përmendura me detaje në pikat 1.11.1 - 1.11.7 të vendimit).

Veç sa më sipër, subjekti, në përgjigje të barrës së provës, ka siguruar dhe depozituar në Komision dokumentacion shtesë, konkretisht kontratën e dhurimit datë 20.1.2011 (me autentifikim nënshkrimi tek noterja M. V., e cila e vërteton këtë dokument me datë 20.1.2011), ku shtetasi Xh. K., djali i tezes, i dhuron xhaxhait K. P. shumën 13,000 euro, pasi është kujdesur për nënën e tij gjatë kohës që shtetasi Xh. K. ka jetuar në shtetin grek. Subjekti ka depozituar dokumentacion provues të të ardhurave të shtetasit Xh. K.

Subjekti në prapësime ka pretenduar se në analizën financiare të personit tjetër të lidhur, xhaxhait K. P., nuk janë përfshirë interesat e përfituara nga depozita e çelur pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 239,346 lekë.

ii) Në lidhje me këstin prej 4,600 euro, ku subjekti dhe bashkëshorti i saj rezultojnë me një pamundësi financiare prej 325,324 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në analizën financiare të Komisionit është përfshirë zëri shpenzime qiraje në shumën 175,000 lekë, në kushtet kur gjatë periudhës objekt analize, 1.1.2013 – 25.7.2013, subjekti i rivlerësimit nuk jetonte me qira, pasi prej datës 12.12.2012 kishte marrë në dorëzim apartamentin nga shoqëria “R.”.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**1.16.3** Komisioni, pasi administroi shpjegimet e subjektit, provat e depozituara prej saj, si dhe e dëgjoi atë në seancën dëgjimore, çmon se në lidhje me ekzistencën e dy mandateve subjekti provoi se në çmimin e blerjes së apartamentit prej 69,690 euro është përfshirë vetëm një pagesë prej 35,000 euro si pjesë e çmimit të apartamentit dhe jo dy pagesa nga 35,000 euro. Ky fakt është konfirmuar edhe nga shoqëria “R.” sh.a. me deklaratat noteriale të përmendura gjatë hetimit, ku konfirmon vetëm një pagesë prej 35,000 euro si pjesë e çmimit total. Gjithashtu, subjekti, për të provuar se çmimi 69,690 euro ishte çmimi real i apartamentit dhe nuk bëhej fjalë për çmim më të lartë apo preferencial, depozitoi në cilësinë e provës kontrata porosie të ngjashme të lidhura nga shoqëria “R.” sh.a. me shtetas të tjerë në të njëjtin pallat për periudhën 2011 – 2013. Komisioni i analizoi këto kontrata, nga ku rezultoi se apartamentet e ndodhura të njëjtin pallat pasqyronin sipërfaqe të përafërta ndërtimi dhe çmime të ngjashme shitjeje me apartamentin e subjektit të rivlerësimit<sup>44</sup>.

**1.16.4** Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, Komisioni nuk konstatoi ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit Antonela Prendi, në cilësinë e gjyqtares, me shoqërinë “R.” sh.a. apo me ortakun/administratorin e saj M. Gj., duke iu referuar specifikisht edhe periudhës së marrëdhënies së interesit, duke filluar nga viti 2011 kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes dhe përfunduar me kontratën e shitjes në vitin 2016, situatë e cila përforcon edhe më tepër faktin e çmimi i blerjes së apartamentit në shumën 69,690 euro është çmimi real i blerjes së tij.

**1.16.5** Komisioni, bazuar në këto fakte e prova, krijoi bindjen se nuk ka asnjë dyshim se çmimi 69,690 euro i pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes dhe në atë të shitjes është çmimi real i blerjes

---

<sup>44</sup>Shihni kontratat e depozituara nga subjekti të pasqyruara në *footnote* 41.

së apartamentit nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka vend për dyshime për çmim më të lartë apo preferencial blerjeje.

**1.16.6** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit provoi se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë bërë pagesa për apartamente të tjera apo për apartamente që personat e lidhur apo të tjerë të lidhur të kenë lidhur me shoqërinë “R.” sh.a. Ky fakt u konfirmua nga ASHK-ja bazuar në vërtetimet e lëshuara prej kësaj të fundit me kërkesë të subjektit, ku vërtetohet se subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur dhe personat të tjerë të lidhur me të, të analizuar më lart, nuk kanë pasuri të paluajtshme të regjistruara pranë saj. Po kështu edhe shoqëria “R.” sh.a. konfirmoi që nuk ka lidhur kontrata për apartament tjetër me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj, ashtu sikurse konfirmon se nuk ka lidhur kontrata për apartamente me personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

**1.16.7** Në lidhje me shumën 1,000 euro zbritje nga shoqëria ndërtuese, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse, duke pasur parasysh edhe faktin që kjo zbritje është e pasqyruar edhe në kontratën e porosisë dhe të shitjes, të përfituar nga negociatat me shoqërinë ndërtuese.

**1.16.8** Në lidhje me burimin e huas prej 28,000 euro, Komisioni, pas prapësimeve të subjektit dhe provave të depozituara pres saj, përfshiu në analizën financiare të rishikuar për personin tjetër të lidhur K. P. (xhaxhai i saj) shumën 13,000 euro, të përfituar prej tij si dhurim (konvertuar në 1,818,050<sup>45</sup> lekë), shumë kjo e përfituar me kontratën e dhurimit të datës 20.1.2011<sup>46</sup>. Ky dokument u depozitua nga subjekti në prapësime si provë shtesë pasi u njoh me balancën negative të dërguar nga Komisioni me rezultatet e hetimit. Komisioni vlerëson se kontrata e dhurimit, nga ku është përfituar shuma 13,000 euro, është dokument i përpiluar në kohën kur është dhënë hua shuma në fjalë dhe konsiderohet si dokument me fuqi provuese në mbështetje të shpjegimeve të subjektit.

**1.16.9** Po kështu, Komisioni përfshiu në analizën financiare edhe të ardhurat nga interesat e depozitës në shumën 239,346 lekë, pasi nga nxjerrja e llogarisë në “Intesa Sanpaolo Bank” provohet ekzistenca e depozitës dhe përfitimi i interesave të saj.

**1.16.10** Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti ambulant i bashkëshortes së xhaxhait M. P. gjatë viteve 1996 – 2004, Komisioni e vlerëson të panevojshme një analizë ekonomiko-ligjore të këtyre të ardhurave, për sa duke marrë në konsideratë të ardhurat në shumën 13,000 euro të përfituar nga dhurimi, si dhe të ardhurat nga interesat bankare në shumën 239,346 lekë, analiza financiare e huadhënësit për krijimin e shumës 28,000 euro është në një vlerë prej -134,472 lekësh, e cila çmohet si një balancë financiare negative me një peshë minimale, që në bazë të parimit të proporcionalitetit nuk vlerësohet se arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>45</sup>Konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të euros për muajin gusht sipas BOA, 1 euro = 139.85 lekë.

<sup>46</sup>Kontratë me autentifikim nënshkrimi tek noterja M. V., e cila e vërteton këtë dokument me datë 20.1.2011.

**1.16.11** Në lidhje me këstin prej 4,600 euro ku subjekti rezultonte me pamundësi financiare prej 325,324 lekësh, Komisioni, pasi verifikoi periudhën e qiradhënies, konstatoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i drejtë dhe, për këtë arsye, në analizën financiare të kryer deri në momentin e pagesës së këstit në datën 25.7.2013, zbriti shpenzimet e qirasë në shumën 175,000 lekë dhe pamundësia financiare rezultoi në shumën -150,324 lekë.

**Komisioni në përfundim vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë të pasurisë apartament, në përputhje me germën “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.**

Mungesa e burimeve të ligjshme financiare në shumën 150,324 lekë nga çmimi total prej 69,690 euro vlerësohet nga Komisioni si një vlerë e papërfillshme e cila, marrë për bazë edhe parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkas për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**2. Depozitë në shumën 500,000 lekë pranë “Raiffeisen Bank”** (depozita është çelur në datën 19.1.2010 dhe mbyllur më 26.1.2012). Pjesa takuese: ½.

**Burimi i krijimit:** të ardhurat e punës së subjektit dhe bashkëshortit E. K.. Interesat e përfituara për periudhën 19.1.2010 – 26.1.2012 janë në shumën 54,900 lekë.

#### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**2.1** Subjekti i rivlerësimit në DIPP/2010 nuk ka deklaruar burimin e krijimit për depozitën 500,000 lekë të krijuar në datën 19.1.2010 në “Raiffeisen Bank”. Rezulton se në DIPP/2009 subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar kursime *cash*. Për këtë arsye, Komisioni, në analizimin e mundësisë financiare për krijimin e depozitës, iu referua periudhës 1.1.2010 – 19.1.2010.

**Tabela nr. 4**

	<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2010 – 19.1.2010</b>
<b>Nr.</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>64,773</b>
1	Të ardhura nga paga e subjektit	64,773
2	Të ardhura nga paga e bashkëshortit	0
	<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
	<b>Shpenzime</b>	<b>21,335</b>
1	Shpenzime jetike	21,335
	<b>Pasuri</b>	<b>470,519</b>
1	Ndryshim likuiditeti ( <i>gjendje likuiditeti në fund - gjendje likuiditeti në fillim</i> )	(29,481)
2	Depozitë në “Raiffeisen Bank” 500,000 lekë, datë 19.1.2010	500,000
	<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-427,081</b>

Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë të ardhura të ligjshme për krijimin e depozitës në datën 19.1.2010 në shumën 500,000 lekë, pasi rezultojnë me balancë negative në shumën -427,081 lekë.

**2.2** “Raiffeisen Bank”<sup>47</sup> konfirmon interesat e krijuara nga depozita bankare e hapur në datën 19.1.2010, përkatësisht në shumat 28,125 lekë për vitin 2010 dhe 26,855 lekë për vitin 2011. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka tërhequr në datën 26.1.2012 shumën 54,900 lekë.

**2.3** Komisioni ka konstatuar gjatë hetimit administrativ se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë mungesë burimesh të ligjshme në shumën 427,081 lekë për çeljen e depozitës prej 500,000 lekësh në datën 19.1.2010 dhe për këtë konstatim subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**2.3.1** Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se nga ana e Komisionit janë marrë në analizë vetëm të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj për një periudhë 19-ditore, 1.1.2010 – 19.1.2010, për shkak se në DIPP-në e vitit pararendës 2009 nuk janë deklaruar kursime *cash* nga prej subjektit. Në përfundim të vitit 2009 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë kursyer nga të ardhurat e siguruara nga marrëdhëniet përkatëse të punës shumën 500,000 leke. Kjo vlerë në janar të vitit pasardhës, vetëm 19 ditë pas përfundimit të vitit kalendarik 2009, është depozituar në bankë.

Është një harresë e paqëllimshme nga ana e subjektit të rivlerësimit mosdeklarimi i gjendjes *cash* prej 500,000 lekësh në fund të vitit 2009, por kjo shumë monetare disponohej prej saj, fakt i provuar edhe nga analiza financiare e Komisionit për vitin 2009, ku subjekti i rivlerësimit rezultoi me balancë pozitive në vlerën 618,752 lekë.

Në konkluzion, në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, balanca negative në shumën -427,081 lekë mbulohet me kursimet nga të ardhurat nga pagat e vitit 2009 në shumën 500,000 leke. Zëri ndryshimet në likuiditet nga -29,481 lekë duhet të jetë -529,481 lekë. Analiza financiare e ndryshuar rezultoi me balancë pozitive në shumën 72,919 lekë.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**2.3.2** Komisioni, pasi administroi shpjegimet e dhëna me shkrim nga subjekti dhe pasi e dëgjoi në seancën dëgjimore, çmon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mungesën e burimeve për çeljen e depozitës prej 500,000 lekësh në datën 19.1.2010 dhe se mosdeklarimi i gjendjes *cash* në datën 31.12.2009 ka qenë harresë e paqëllimshme.

**2.3.3** Komisioni konstaton se në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe personi i lidhur me të, bashkëshorti i saj, kanë deklaruar përveç depozitës prej 500,000 lekësh edhe interesat e përfituara nga kjo depozitë, me burim krijimi kursime nga të ardhurat e siguruara nga puna, çka vërteton në mënyrë shteruese se si burim krijimi për depozitën prej 500,000 lekësh kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit të saj, që do të thotë kursimet e vitit 2009 dhe jo të ardhurat për periudhën 1.1.2010 – 19.1.2010.

---

<sup>47</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021.

Komisioni vlerëson se ka një lidhje logjike, ekonomike dhe ligjore që të krijon bindjen se burimi i krijimit të depozitës prej 500,000 lekësh në datën 19.1.2010 janë pikërisht kursimet e vitit 2009, për arsye se:

- Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar si burim kursimet nga të ardhurat nga paga, deklarim që detyrimisht lidhet me balancën financiare dhe mundësinë për kursim të vitit 2009.
- Është plotësisht e pamundur dhe pa logjikë financiare që subjekti dhe personi i lidhur të kenë mundësuar kursimin e një shume prej 500,000 lekësh vetëm me të ardhurat për periudhën 1.1.2010 – 19.1.2010, çka përsëri do të thotë që burimi i krijimit lidhet me mundësinë financiare për kursim në vitin 2009.
- Analiza financiare për periudhën 1.1.2010 – 19.1.2010 përfshin si të ardhura të ardhurat nga paga e muajit dhjetor 2009, çka e lidh automatikisht mundësinë për kursim të shumës prej 500,000 lekësh me rezultatin e analizës financiare dhe mundësinë për kursim të vitit 2009.
- Referuar analizës financiare të vitit 2009 konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi për kursim në datën 31.12.2009 në shumën 618,752 lekë, shumë kjo mëse e mjaftueshme për t'u investuar në depozitën prej 500,000 lekësh në datën 19.1.2010.
- Komisioni, në vijim të kësaj linje logjike, mban parasysh edhe qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>48</sup>, në bazë të së cilës ka konkluduar se për sa kohë pavarësisht pasaktësisë në deklarin e vitit 2009 (mosdeklarimi i gjendjes *cash* 500,000 lekë), nga analiza financiare e vitit 2009 e kryer nga Komisioni rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur një tepëriçë pozitive në këtë vit në vlerën 618,752, që mbulon krijimin e shumës së depozitës në llogari bankare në janar të vitit 2010.

**2.3.4** Komisioni, për efekt të analizës financiare të vitit 2009, pas rilogaritjeve përkatëse, duke çmuar sa është arsyetuar më sipër, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të justifikojnë me burime financiare të ligjshme krijimin e depozitës në shumën 500,000 lekë.

**Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të saktë të depozitës në shumën 500,000 lekë, në përputhje me germën “a” të pikës 5 të nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe subjekti provoi burimin e ligjshëm të kësaj depozite në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

**3. Automjet tip “Opel Corsa”, me targa \*\*\*, blerë sipas kontratës së datës 14.5.2006<sup>49</sup> me çmimin 250,000 lekë. Pjesa takuese: ½.**

**Burimi i krijimit:** të ardhurat e punës së subjektit dhe bashkëshortit E. K.

**Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

---

<sup>48</sup>Vendim i Kolegjit nr. 33/2021 të subjektit të rivlerësimit N. T.

<sup>49</sup>Kontratë blerjeje nr. \*\*\*, datë 14.5.2006, e automjetit tip “Opel Corsa”.

**3.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë blerjen e këtij automjeti në DIPP/2006 në vlerën 250,000 lekë, ndërsa shitjen e tij në DIPP/2009 për çmimin 200,000 lekë.

**3.2** Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR)<sup>50</sup> ka konfirmuar se automjeti tip “Opel Corsa” me targa \*\*\* ka qenë në pronësi të shtetasit E. K. dhe është përfituar nga kontrata e shitblerjes datë 14.5.2006, me shitës shtetasin M. A., për çmimin 250,000 lekë. Automjeti ishte blerë më parë nga ky i fundit në shtetin italian në datën 10.2.2006 për çmimin 300 euro ose 36,714 lekë<sup>51</sup>. Nga dokumenti doganor i datës 19.2.2006 shitësi M. A. ka paguar detyrimet doganore në vlerën 107,378 lekë dhe në total automjeti ka kushtuar 107,378 lekë + 36,714 lekë = 144,092 lekë. Më pas ky automjet me kontratën e datës 12.10.2009<sup>52</sup> i është shitur nga bashkëshorti i subjektit blerësit Gj. Ç. me çmimin 200,000 lekë.

**3.3** Komisioni, referuar burimit të krijimit të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, kreu analizën financiare për mundësinë e blerjes së automjetit në datën 14.5.2006 me të ardhurat e vitit 2006, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* në vitet e mëparshme.

**Tabela nr. 5**

	<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2006 - 14.5.2006</b>
<b>Nr.</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>284,460</b>
1	Të ardhura nga paga e subjektit	284,460
2	Të ardhura nga paga e bashkëshortit	0
	<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
	<b>Shpenzime</b>	<b>139,842</b>
1	Shpenzime jetike	79,842
2	Shpenzime qiraje	60,000
	<b>Pasuri</b>	<b>227,475</b>
1	Ndryshim likuiditeti ( <i>gjendje likuiditeti në fund - gjendje likuiditeti në fillim</i> )	(22,525)
2	Automjet “Opel Corsa” blerë më 14.5.2006	250,000
	<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri</b>	<b>-82,856</b>

**3.4** Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë mungesë burimesh të ligjshme në shumën 82,856 lekë për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa” në datën 14.5.2006. Për këtë konstatim subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**3.5** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se kjo diferencë negative vjen si rezultat i mosdeklarimit të kursimeve nga paga dhe mosdeklarimi i gjendjes *cash* në DIPP/2005. Në vitet paraardhëse, kryesisht 2004 dhe 2005, subjekti ka krijuar kursime nga paga e saj të cilat nuk kanë qenë në vlera të mëdha. Në këtë periudhë nuk ka shtuar

<sup>50</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2022, e DPSHTRR-së.

<sup>51</sup>Konvertuar sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, ku me datë 19.2.2006 (merret data 17.2.2006, pasi për datat 18 dhe 19 nuk ka informacion) 1 euro = 122.38 lekë.

<sup>52</sup>Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 12.10.2009, e automjetit tip “Opel Corsa”.

asnjë pasuri dhe kursimet e krijuara me të ardhurat nga paga shërbyen si burim për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa”. Kursimet nga paga kanë qenë të vogla por që mbulojnë pamundësinë në shumën 82,856 lekë.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**3.6** Komisioni, pasi administroi dokumentacionin, shpjegimet e subjektit, si dhe e dëgjoi në seancën dëgjimore, çmon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë në kuadër deklarativ dhe mbeten të paprovuara me dokumentacion ligjor. Përveç faktit se subjekti, kursimet e pretenduara ndër vite në shuma të vogla nuk i ka deklaruar si gjendje në DIPP-të përkatëse, gjatë hetimit administrativ nuk arriti të përcaktojë në vlerë se sa ishin këto shuma. Për rrjedhojë, subjekti dështoi të provojë të kundërtën e barrës së provës të dërguar nga Komisioni.

**Komisioni në përfundim vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në mbështetje të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 82,856 lekë për blerjen e këtij automjeti, mungesë e cila në respektim të parimit të proporcionalitetit vlerësohet e papërfillshme në lidhje me rezultatin e vlerësimit të subjektit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë.**

**4. Automjet tip “Ford Focus” me targa \*\*\***, blerë nga bashkëshorti E. K. sipas kontratës datë 19.10.2009<sup>53</sup>, me çmimin 250,000 lekë. Pjesa takuese: ½.

**Burimi i krijimit:** 200,000 lekë nga shitja e automjetit tip “Opel Corsa” dhe 50,000 lekë të ardhura nga puna e subjektit dhe bashkëshortit E. K..

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**4.1** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë blerjen e këtij automjeti në DIPP/2009 në vlerën 250,000 lekë, ndërsa në DIPP/2015 ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në shumën 2,000 euro.

**4.2** DPSHTRR-ja<sup>54</sup> konfirmon se ky automjet ka qenë i regjistruar në emër të shtetasit E. K. (aktualisht rezulton i regjistruar në emër të shtetasit Ndue Pepkolaj) dhe e ka përfutur nga kontrata e datës 19.10.2009 nga shitësi A. S., me çmimin 250,000 lekë.

**4.2.1** Nga dokumentacioni rezulton se shitësi A. S. e kishte blerë këtë automjet në shtetin italian më 14.10.2009, me çmimin 800 euro ose 110,160 lekë<sup>55</sup>. Shitësi A. S. ka paguar edhe taksën doganore me datë 15.10.2009, në vlerën 148,264 lekë, dhe në total automjeti ka kushtuar 110,160 lekë + 148,264 lekë doganë = 259,224 lekë. Rezulton që pas 4 ditësh, kur është paguar taksa doganore, shtetasi A. S. ia shet në datën 19.10.2009 shtetasit E. K. me çmimin 250,000 lekë, me një diferencë prej 9,224 lekësh më lirë se e ka blerë automjetin. Më pas automjeti tip “Ford Focus” është shitur nga bashkëshorti E. K. blerësit B. H., sipas kontratës së datës 1.4.2015<sup>56</sup>, kundrejt çmimit 2,000 euro.

<sup>53</sup>Kontratë blerjeje nr.\*\*\*, datë 19.10.2009, e automjetit tip “Ford Focus”.

<sup>54</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2022, e DPSHTRR-së.

<sup>55</sup>Referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, ku me datë 14.10.2009 1 euro = 138.7 lekë.

<sup>56</sup>Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 1.4.2015, e automjetit tip “Ford Focus”.

**4.3** Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. S. dhe për këtë qëllim ka administruar përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>57</sup>, ku nga verifikimi nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi.

**4.4 Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të automjetit tip “Ford Focus” në datën 19.10.2009, në shumën 250,000 lekë.**

**4.4.1** Sipas deklaratës *Vetting* si burim krijimi për blerjen e automjetit tip “Ford Focus” në datën 19.10.2009, në shumën 250,000 lekë, janë deklaruar: (a) të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Opel Corsa” në datën 12.10.2009 në shumën 200,000 lekë; dhe (b) të ardhurat nga puna e subjektit dhe e bashkëshortit në shumën 50,000 lekë.

**4.4.2** Komisioni i konsideroi të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Opel Corsa” në shumën 200,000 lekë, të përfituara në datën 12.10.2009, si të ardhura të ligjshme. Për sa i përket shumës 50,000 lekë, nga analiza financiare për vitin 2009, subjekti rezulton me balancë pozitive. Nga analiza e kryer në datën e blerjes së automjetit, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit.

**Tabela nr. 6**

	<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2009 – 19.10.2009</b>
<b>Nr.</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>1,123,031</b>
1	Të ardhura nga paga e subjektit	680,288
2	Të ardhura nga paga e bashkëshortit	442,743
3	Të ardhura nga shitja e automjetit “Opel Corsa”	200,000
	<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
	<b>Shpenzime</b>	<b>551,765</b>
1	Shpenzime jetike	326,765
2	Shpenzime qiraje	225,000
	<b>Pasuri</b>	<b>211,586</b>
1	Ndryshim likuiditeti ( <i>gjendje likuiditeti në fund - gjendje likuiditeti në fillim</i> )	(38,414)
2	Automjet “Ford Focus”, datë 19.10.2009	250,000
	<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>359,680</b>

**Nga hetimi administrativ i Komisionit nuk u konstatuan problematika në lidhje me deklarimin dhe burimin e krijimit të automjetit tip “Ford Focus”.**

**5. Automjet tip “Daimler Chrysler” i vitit 2004, me targa \*\*\***, blerë nga bashkëshorti i subjektit E. K. sipas kontratës së blerjes datë 27.3.2015<sup>58</sup>, me çmimin 3,000 euro. Pjesa takuese: ½.

<sup>57</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; përgjigja nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>58</sup>Kontratë blerjeje e automjetit tip “Daimler Chrysler” me nr. \*\*\*, datë 27.3.2015.



**Burimi i krijimit:** 2,000 euro nga shitja e automjetit tip “Ford Focus” dhe 1,000 euro të ardhura nga puna e subjektit dhe bashkëshortit E. K.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**5.1** Bashkë me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar kontratën e blerjes së automjetit datë 27.3.2015, me shitës L. M. dhe blerës E. K., me çmimin 3,000 euro, paguar tërësisht nga blerësi.

**5.2** Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DIPP/2015 me vlerë 3,000 euro, me të njëjtin burim të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

**5.3** DPSHTRR-ja<sup>59</sup> ka konfirmuar regjistrimin e automjetit tip “Daimler Chrysler”, me targa \*\*\*, në emër të shtetasit E. K., i përfituar nga kontrata e datës 27.3.2015 me shitës L. M., për çmimin 3,000 euro. Nga dokumentacioni rezulton se shitësi L. M. e ka blerë këtë automjet në shtetin gjerman në çmimin 5,700 euro, me datë 25.3.2015 dhe ka paguar taksën doganore më 27.3.2015 në shumën 166,431 lekë ose 1185 euro<sup>60</sup>. Në total automjeti ka kushtuar 5,700 euro + 1,185 euro = 6,885 euro.

Rezulton që ditën e pagimit të taksës doganore shitësi L. M. ia shet shtetasit E. K. me një diferencë 3,885 euro me humbje se vlera totale që e ka blerë.

**5.4** Komisioni, lidhur me transaksionet e shitblerjes të automjetit tip “Daimler Chrysler”, ku shitësi L. M. ka paguar për blerjen e këtij mjeti vlerën totale prej 6,885 euro dhe po në datën 27.3.2015 ia ka shitur bashkëshortit të subjektit me çmimin 3,000 euro (me humbje 3,885 euro), ngriti dyshime në lidhje me vlerën reale të blerjes së automjetit nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti i saj.

**5.5** Marrë në konsideratë këtë diferencë të çmimit të blerjes së automjetit nga shitësi me atë të shitjes bashkëshortit të subjektit, Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit L. M.<sup>61</sup>, ku nga verifikimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

### **5.6 Në lidhje me burimin e krijimit të automjetit tip “Daimler Chrysler” në datën 27.3.2015**

**5.6.1** Sipas deklarimit në DIPP/2015 dhe atij *Vetting*, si burim krijimi për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler” në datën 27.3.2015, në shumën 3,000 euro, janë deklaruar:

- a) të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Ford Focus” në datën 1.4.2015, në shumën 2,000 euro;
- b) të ardhurat nga puna e subjektit dhe e bashkëshortit në shumën 1,000 euro.

**5.6.2** Duke marrë në konsideratë për sa u analizua më sipër në pikën 5.4 në lidhje me vlerën reale të blerjes së automjetit, Komisioni, në analizën e kryer për burimin e krijimit të tij, ka marrë parasysh deklarimin e subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e përdorura janë nga shitja e automjetit tip “Ford Focus” dhe të ardhurat nga puna e subjektit dhe e bashkëshortit, të cilat duhet të jenë në shumën 4,885 euro për të plotësuar vlerën e automjetit të analizuar prej 6,885 euro.

<sup>59</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, e DPSHTRR-së.

<sup>60</sup>Konvertuar sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë së datës 27.3.2015, ku 1 euro = 140.40 lekë.

<sup>61</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**5.6.3** Komisioni konstaton se të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Ford Focus” në shumën 2,000 euro, të përfituara në datën 1.4.2015, nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler” në datën 27.3.2015, pasi ato janë përfitur në datën 1.4.2015, 6 ditë pas blerjes së automjetit të ri, datë 27.3.2015.

**5.6.4** Në lidhje me këtë problematikë, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar në pyetëtorin nr. 2 se blerësi B. H. në kushte mirëbesimi ka parapaguar çmimin e blerjes së automjetit tip “Ford Focus” me datë 27.3.2015 në vlerën 2,000 euro dhe kontrata e shitjes u formalizua nga palët në datën 1.4.2015, vetëm 4 ditë më vonë. Parapagimi i çmimit u kërkua nga subjekti dhe bashkëshorti i saj për nevoja të blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”. Shuma prej 2,000 euro e parapaguar nga blerësi B. H. përbën një pjesë të burimit financiar të blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”.

**5.6.5** Pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti në lidhje me sa më sipër, Komisioni mori në konsideratë shumën 2,000 euro ose 280,680 lekë<sup>62</sup> si burim i mundshëm për blerjen e automjetit, duke pasur parasysh kohën e shkurtër të ndodhjes së këtyre transaksioneve. Komisioni mori në analizë si të ardhura nga shitja e automjetit vetëm shumën 250,000 lekë<sup>63</sup>.

**5.6.6** Komisioni analizoi mundësinë e kursimit të shumës 4,885 euro deri në datën 27.3.2015, nga ku rezultoi si vijon:

**Tabela nr. 7**

	<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2015 – 27.3.2015</b>
<b>Nr.</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>375,718</b>
1	Të ardhura nga paga e subjektit	266,532
2	Të ardhura nga paga e bashkëshortit	109,186
3	Të ardhura nga vajza	5,000
	<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
	<b>Shpenzime</b>	<b>238,915</b>
1	Shpenzime jetike	208,915
2	Shpenzime udhëtimi	0
3	Shpenzime shkollimi	30,000
	<b>Pasuri</b>	<b>626,993</b>
1	Ndryshim likuiditeti ( <i>gjendje likuiditeti në fund - gjendje likuiditeti në fillim</i> )	(58,861)
2	Shuma 4,885 euro për “Daimler Chrysler” (burimi i dytë - kursimet)	685,854
	<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-490,189</b>

Në përfundim rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler” me çmimin 6,885 euro, në datën 27.3.2015, në shumën 490,189 lekë.

**5.6.7** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

<sup>62</sup>Konvertuar sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë së datës 1.4.2014, ku 1 euro = 140.34 lekë.

<sup>63</sup>Të ardhurat e përfituara nga shitja në datën 1.4.2015 prej 280,680 lekësh janë në një vlerë më e madhe se çmimi i blerjes prej 250,000 lekësh dhe për diferencën prej 30,680 lekësh subjekti nuk ka paguar tatim për të ardhurat e krijuara.

a) Ka dyshime për vlerën reale të blerjes së automjetit tip “Daimler Chrysler” i blerë me çmimin 3,000 euro, të pasqyruar në kontratën e shitjes, duke e krahasuar me diferencën prej 3,885 euro shitur më lirë nga shitësi në po të njëjtën ditë që ka paguar vlerën doganore dhe për këtë subjekti duhet të provojë që vlera reale e blerjes së automjetit është 3,000 euro.

b) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler” me çmimin 6,885 euro në datën 27.3.2015, në shumën 490,189 lekë.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**5.6.8** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore, ka dhënë të njëjtat shpjegime<sup>64</sup>. Subjekti ka shpjeguar se çmimi i blerjes së automjetit tip “Daimler Chrysler” është 3,000 euro, sikurse pasqyrohet në kontratën e shitblerjes. Shitësi L. M. banon në një lagje me subjektin dhe përpara nënshkrimit të kontratës automjetin ia nënshtruan kontrollit teknik dhe diagnostikimit kompjuterik, ku u evidentua se disa elemente nuk ishin në parametra optimale, gjë që diktonte riparimin e tyre në një kohë të afërt. Bazuar në preventivin e datës 27.3.2015, në kushtet kur automjetit i duheshin bërë riparimet e mësipërme, shitësi dakordësoi shitjen në shumën 3,000 euro, që u vlerësua një rast i mirë nga ana e subjektit dhe bashkëshortit të saj.

Disa muaj më vonë, në datën 1.9.2015 janë kryer shërbimet e riparimit në lidhje me problematikat e pasqyruara në fletë-daljen e datës 1.9.2015 në vlerën 186,500 lekë.

**5.6.8.1** Subjekti ka theksuar se Komisioni duhet të marrë në analizë financiare shumën 3,000 euro si vlerë të blerjes së automjetit, ashtu sikurse është pasqyruar në kontratën e shitblerjes. Nëse Komisioni në analizën e tij i referohet shumës 6,885 euro si çmim i blerjes së automjetit, sërish subjekti i rivlerësimit rezulton në mundësi të plota financiare për disponimin e kësaj vlere në datën 27.3.2015, pasi Komisioni duhet të përlllogarisë në burimin e krijimit e kësaj pasurie edhe gjendjen *cash* të deklaruar rregullisht në deklaratën periodike të vitit pararendës 2014 në shumën 500,000 lekë. Në ditën e blerjes së automjetit kjo vlerë disponohej nga subjekti i rivlerësimit, pasi përgjatë periudhës 1.1.2015 – 27.3.2015 subjekti i rivlerësimit nuk ka krijuar asnjë pasuri tjetër që mund të sillte pakësimin e gjendjes *cash*.

**5.6.8.2** Subjekti depozitoi në cilësinë e provës situacion punimesh lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., e datës 27.3.2015, ku për problemet e konstatuara shërbimi i tyre shkon në një vlerë totale prej 186,500 lekësh, si dhe fletëdaljen nr. 1, datë 1.9.2015, e lëshuar po nga kjo shoqëri për shërbimet e kryera në vlerën 186,500 lekë.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**5.6.9** Komisioni, pasi administroi dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe e dëgjoi në seancën dëgjimore, çmon se subjekti nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në

---

<sup>64</sup>Shihni me detaje prapësimet në dosje.

lidhje me çmimin e blerjes së automjetit në shumën 3,000 euro, pavarësisht se ai është pasqyruar si i tillë në një dokument ligjor, siç është kontrata e shitblerjes. Shitja e automjetit nga shitësi ditën e pagimit të taksës doganore bashkëshortit të subjektit me vlerë 3,000 euro (me humbje 3,885 euro) është veprim financiar i pajustificuar edhe pse sipas subjektit ditën e shitjes së automjetit iu konstatuan probleme teknike që do të kushtonin 186,500 lekë ose 1,328 euro<sup>65</sup>. Komisioni gjithashtu vëren se vlera 1,328 euro, vlerë që do t'i kushtonte subjektit dhe bashkëshortit të saj për të rregulluar defektin e automjetit, nuk justifikon përfitimin e mjetit nga shitësi me ulje 3,885 lekë nga çmimi total që e kishte blerë ai, ulja që do t'i bëhej nga shitësi në këtë rast do të ishte në nivelin e 1,328 euro, por jo me humbje.

Gjithashtu, pretendimi i subjektit se edhe po të merret vlera 6,885 euro si çmim blerjeje për automjetin subjekti i rivlerësimit rezulton me mundësi financiare për blerjen e tij, pasi ka disponuar në datën 27.3.2015 edhe gjendjen *cash* prej 500,000 lekësh të deklaruar në DIPP/2014, ky pretendim nuk qëndron, pasi në DIPP/2015 subjekti deklaroi si burim për pagesën 3,000 euro të datës 9.3.2015, kursime nga të ardhurat vjetore të punës për vitin 2014 në shumën 500,000 lekë. Pra shuma që subjekti pretendon se ka disponuar në datën 27.3.2015 prej 500,000 lekësh është shpenzuar në datën 9.3.2015 kur ka paguar këstin e apartamentit prej 3,000 euro ose 420,900 lekë. Edhe nëse Komisioni do të konsiderojë si burim për blerjen e pasurisë vetëm shumën e mbetur nga gjendja *cash* prej 79,100 lekësh (500,000 - 420,900), të cilën subjekti pavarësisht se nuk e ka deklaruar si burim krijimi e ka disponuar në datën 27.3.2015, mungesa e burimeve të ligjshme në momentin e blerjes së automjetit do të bëhet 411,089 lekë (490,189 - 79,100).

**Komisioni në përfundim vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në mbështetje të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën -411,089 lekë për blerjen e këtij automjeti, mungesë e cila në respektim të parimit të proporcionalitetit vlerësohet me peshë minimale në lidhje me rezultatin tërësor të analizës financiare për subjektin e rivlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë.**

**6. Gjendje *cash* (në banesë) në shumën 500,000 lekë.** Pjesa takuese: ½.

**Burimi i krijimit:** të ardhurat e punës së subjektit dhe bashkëshortit E. K.

**6.1** Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni kreu analizën e ecurisë së likuiditeteve *cash* ndër vite, shtesave/pakësimeve, me qëllim verifikimin e gjendjes së mundshme të këtyre likuiditeteve në fund të vitit 2016 në raport me verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit të bërë në deklaratën *Vetting*.

**6.2** Nga përlllogaritjet sipas deklaratimeve ndër vite, rezultoi se gjendja *cash* në datën 31.12.2016 është në shumën 400,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* (datë 26.1.2017) gjendja është në shumën 500,000 lekë.

**6.3** Nga veprimet bankare në llogaritë e pagës në “Credins Bank” të kryera nga subjekti dhe bashkëshorti i saj rezulton të jetë tërhequr shuma 121,000 lekë për periudhën 1.1.2017 – 26.1.2017

<sup>65</sup>Llogaritur sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë së datës 27.3.2015, ku 1 euro = 140.40 euro.

(data e plotësimit të deklaratës *Vetting*). Këto tërheqje janë të mjaftueshme për të siguruar shtesën e kursimeve *cash* prej 100,000 lekësh të ndodhur nga data 31.12.2016 (gjendje *cash* 400,000 lekë) në datën 26.1.2017 (gjendje *cash* 500,000 lekë).

**6.4** Gjithashtu, referuar analizës financiare të subjektit të rivlerësimit për vitet 2014 - 2016, duket se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasuritë, ndër të cilat edhe gjendjen *cash* të deklaruar për vitet 2014 dhe 2016, por rezultojnë me balancë negative në shumën 256,542 lekë. Për këtë balancë negative barra e provës është kaluar në analizën financiare të viteve 2004 - 2016.

## **PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN, BASHKËSHORTI E. K.**

**7. Pjesë e pandarë 7/252 (bashkëpronësi) e pasurisë selishtë me sip. 12,000 m<sup>2</sup>, e ndodhur në \*\*\*, Korçë,** e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. \*\*\*, datë 24.10.2016, në pronësi të shtetasit E. K., përfituar nga i ati V. K. përmes aktit noterial “heqje dorë nga pronësia”, nr. \*\*\*, datë 26.9.2016. Pjesa takuese: 100%.

**Burimi i krijimit:** vendimi nr. \*\*\*, datë 24.1.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**7.1** Bashkë me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar dokumentacionin<sup>66</sup> e përfitimit të kësaj pasurie, nga ku rezulton se shtetasi E. K. ka përfituar 7/252 pjesë e pandarë nga pasuria me sip. 12,000 m<sup>2</sup> nga heqja dorë e kësaj pronësie nga babai i tij V. K. në favor të tij. Kjo pasuri ishte përfituar nga babai i tij V. K. si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore dhe nga trashëgimia.

Në deklaratën noteriale datë 26.9.2016<sup>67</sup>, shtetasi V. K. deklaron se është bashkëpronar mbi 7/252 pjesë të pandarë mbi një selishtë me sip. 12,000 m<sup>2</sup> të ndodhur në fshatin \*\*\*, Korçë, z. k. \*\*\* dhe heq dorë nga pronësia mbi pjesën e tij në favor të djalit të tij E. K..

**7.2** ASHK Drejtoria Vendore Korçë<sup>68</sup> konfirmon të regjistruar në emër të shtetasit E. K. pasurinë e llojit “arë” me sip. 12,000 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, ndodhur në z. k. \*\*\*, \*\*\*, Korçë, ku shtetasi E. K. mban cilësinë e bashkëpronarit në pjesën takuese 42/1512.

**Komisioni gjatë hetimit administrativ nuk konstatoi problematika në lidhje me pasurinë e përfituar nga bashkëshorti i subjektit E. K. nga trashëgimia ligjore si bashkëpronar në fshatin \*\*\*, Korçë.**

<sup>66</sup>Dokumenti “Njoftim vendimi” nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2013, lëshuar nga AKKPronave; vendimi nr. \*\*\*, datë 3.4.2013, i AKKP-së me kërkues Q. K., përfaqësues i trashëgimtarëve të subjektit K. K., me objekt “njohja e të drejtës së pronësisë, kthimi ose kompensimi i pronës me sip. 82,100 m<sup>2</sup> të ndodhur në fshatin \*\*\*, Korçë”. Në përfundim AKKP-ja vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit K. K.; vendimi nr. \*\*\* datë 20.5.2013, i AKKP-së, për rrëzimin e kërkesës me kërkues A. K., përfaqësues i trashëgimtarëve të subjektit K. K. dhe mosnjohjen e të drejtës së pronës me sip. 2325 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin \*\*\*, Korçë; vendimi nr. \*\*\*, datë 24.1.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës Q. K., i paditur AKKP, me objekt “anulimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 3.4.2013, të AKKP-së për njohjen e të drejtës së pronësisë së pronës me sip. 82,100 m<sup>2</sup> trashëgimtarëve të K. K., kthimin e 12,000 m<sup>2</sup> të pasurisë selishtë etj., e cila ka vendosur të pranojë pjesërisht padinë duke kthyer fizikisht sipërfaqen 31,580 m<sup>2</sup>, e përbërë nga pasuritë 12,000 m<sup>2</sup> etj., trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar K. K. etj.”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.1.2014; dëshmi trashëgimie nr. \*\*\*, datë 8.7.2016, i trashëgimlënësit P. K.; vërtetimi hipotekor datë 16.9.2016, i lëshuar nga ZVRPP-ja Korçë për pasurinë me sip. 12,000 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Korçë regjistruar në emër të 15 bashkëpronarëve, përfshirë edhe shtetasin V. K. për 7/252 pjesë.

<sup>67</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 26.9.2016, me deklarues V. K..

<sup>68</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021, e ASHK-së Korçë.

## KONSTATIME TË TJERA

### 8. Në lidhje me pasurinë truall me sip. 70.25 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 20.66 m<sup>2</sup> në pronësi të shtetas I. P. (nëna e bashkëshortit të subjektit)

#### Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

**8.1** Komisioni ka administruar regjistrin e veprimeve noteriale<sup>69</sup> të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të dhe ka kërkuar dokumentet nga zyrat përkatëse noteriale.

**8.2** U administrua përgjigja e noterit B. Z., ku nga dokumentacioni i dërguar rezultoi një kontratë sipërmarrjeje e datës 3.2.2016<sup>70</sup>, me sipërmarrës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe investitore I. P., me objekt “ofrimi i asistencës teknike për ndërtimin e godinës së banimit me ambiente shërbimi 2-3 kate + bodrum për rikonstruksion kati, shtesë anësore për llogari të investitorit”. Çmimi i sipërmarrjes do të jetë 150,000 lekë.

**8.3** Komisioni ka administruar edhe përgjigjen e ASHK Drejtoria Vendore Korçë<sup>71</sup> të përfitimit të kësaj pasurie<sup>72</sup>. ASHK-ja konfirmon të regjistruar në pronësi të shtetas I. P. pasurinë e llojit “truall” me sip. 70.25 m<sup>2</sup> dhe 20.66 m<sup>2</sup> ndërtesë, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, ndodhur në z.k. \*\*\*, Korçë. Në praktikën e përcjellë nga ASHK-ja nuk gjendet i depozituar dokumentacioni i pasqyruar në kartelën e pasurisë përmendur më lart.

**8.4** Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se nisur nga fakti që në ASHK nuk rezulton i depozituar dokumentacioni i pasqyruar në kartelën e pasurisë “\*\*\*\*, leje ndërtimi, leje përdorimi, plan vendosje, projekt godinë 2-kt + bodrum për shërbime dhe banim, arkivohet Ç. P., datë 8.9.2015”, për të hequr çdo dyshim për ndonjë pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur me të apo edhe personave të tjerë të lidhur:

**a)** Subjekti i rivlerësimit të japë shpjegime shteruese, duke provuar historikun e pasurisë, investimin e kryer në të dhe vlerën e tij nga momenti që shtetasja I. P. është bërë pronare e pjesës së saj (me sip. 70.25 m<sup>2</sup> truall dhe 20.66 m<sup>2</sup> ndërtesë), duke depozituar dokumentacion ligjor.

**b)** Subjekti i rivlerësimit të shpjegojë cili është qëllimi i investimit në këtë pasuri dhe nga kush përdoret nga momenti i kryerjes së investimit e deri aktualisht, duke e shoqëruar shpjegimin e saj me dokumentacion mbështetës.

<sup>69</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2022, e Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>70</sup>Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 3.2.2016.

<sup>71</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Korçë.

<sup>72</sup>1) Nga dokumentacioni rezulton se shtetasi M. P. (babai i I. P.), me kontratën e dhurimit datë 5.9.1988, i dhuron bashkëshortes së tij V. P. një shtëpi banimi nr. \*\*\*, 2-katëshe, e përbërë nga 2 dhoma të mëdha dhe 1 të vogël e korridor, e poshtë kuzhinë e qilar, me sipërfaqe të ndërtuar 61.10 m<sup>2</sup>, ndodhur në Korçë, rruga “\*\*\*\*”; 2) me kontratën e dhurimit datë 6.9.1995, shtetasja V. P. i dhuron vajzës së saj I. P. shtëpinë e banimit si më lart; 3) me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.12.1999, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë për trashëgimlënësin M. P. (i cili ka ndërruar jetë në datën 25.4.1999), ku përcakton si trashëgimtar ligjor të radhës së parë bashkëshorten V. dhe fëmijët P., Dh., V. dhe I. P., të cilët trashëgojnë 1/5 pjesë takuese të pasurisë së trashëgimlënësit; 4) me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 3.4.2001, të Gjykatës së Apelit Korçë janë njohur bashkëpronarë me pjesë të barabarta me ¼ trashëgimtarët I., Dh., P. dhe V. P. të pasurisë truall me sip. 278.40 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 75.10 m<sup>2</sup> sipas certifikatës së pronësisë datë 20.7.2015; 5) me kontratën e pjesëtimit vullnetar datë 2.8.2015 palët Dh., P. dhe V. P. vendosin që shtetasja I. P. të marrë në pronësi të saj pjesën me sip. 70.25 m<sup>2</sup> truall dhe 20.66 m<sup>2</sup> ndërtesë.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**8.5** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet dhe gjatë seancës dëgjimore, ka dhënë të njëjtat shpjegime ku, ndër të tjera<sup>73</sup>, sqaron se shtetasja I. P. ka qenë pronare e një banese në Korçë me sip. 61.10 m<sup>2</sup>, dykatëshe, e përbërë nga dy dhoma të mëdha etj., të cilën e ka përfituar nga një kontratë dhurimi nga nëna e saj. Pas disa proceseve gjyqësore që shtetasja I. P. ka pasur me vëllezërit e saj për shkak të kësaj kontrate dhurimi, pasi ata arritën në një konsensus vendosën me një kontratë pjesëtimi vullnetar që I. P. të marrë në pronësi të saj pjesën A me sip. 70.25 m<sup>2</sup> truall, nga e cila 20.66 m<sup>2</sup> ndërtesë. Pas pjesëtimin shtetasja I. P. e regjistroi pjesën e saj takuese, sikurse provohet nga certifikata e pronësisë datë 8.9.2015. Meqenëse banesa ishte e viteve 1960 dhe për shkak të amortizimit të lartë të saj, shtetasja I. P., në cilësinë e pronares, ka nisur procedurat për pajisje me leje ndërtimi nga Bashkia Korçë. Situacioni përfundimtar i punimeve rezulton në vlerën 6,122,523 lekë. Banesa e ndërtuar sipas lejes së miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.2.2016, të Bashkisë Korçë është bashkinvestim i shtetasës I. P., djalit të saj N. Dh, dhe nuses së djalit F. Dh., me të cilët jeton në një përbërje familjare. Sipas dokumentacionit të përcjellë nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë, shtetasi E. K. është shkëputur nga përbërja familjare e nënës së tij I. P. në datën 8.4.2005 kur ishte ende beqar. Në vijim shtetasja I. P. ka mbetur në përbërje familjare me djalin tjetër N. Dh. dhe nusen e tij A. Dh.. Shtetasi E. K. ka jetuar prej vitit 2004 në Tiranë ku kanë qenë edhe në marrëdhënie pune, referuar librezës së tij të punës. Familja e saj, sqaron subjekti, ka pasur përbërje të veçantë familjare dhe gjendje civile të regjistruar fillimisht në Njësinë Administrative Nr. \*\*\* Tiranë dhe më pas në Njësinë Administrative Nr. \*\*\* Tirane. Subjekti i rivlerësimit nuk ka jetuar asnjëherë në qytetin e Korçës dhe nuk ka qenë asnjëherë në përbërje familjare me znj. I. P.. Për ndërtimin e banesës në qytetin e Korçës, ku edhe aktualisht jetojnë, kanë investuar znj. I. P., djali i saj N. Dh. dhe nusja e djalit F. Dh.. Përveç kursimeve ndër vite nga të ardhurat nga paga dhe puna e tyre, si burim krijimi për ndërtimin e banesës kanë shërbyer edhe burimet financiare, si vijon: (a) shija e një apartamenti nga shtetasja I. P. me kontratën e datës 17.9.2009 në vlerën 2,300,000 lekë (apartament i përfituar më parë nga privatizimi); (b) kredi e marrë në shumën 1,660,000 lekë në BKT nga shtetasja F. Dh. “kredi për ndërtim shtëpie”; (c) kredi e marrë në shumën 500,000 lekë në BKT nga shtetasit N. e F. Dh. për ndërtim banese; (ç) kredi e marrë në shumën 2,000,000 lekë në BKT nga shtetasja F. Dh. “kredi për rregullim shtëpie”. Gjithashtu FSHU-ja dhe UKT-ja konfirmojnë abonente familjare I. P. Subjekti ka depozituar të gjithë dokumentacionin ligjor të ndërtimit të shtëpisë së deklaruar më lart<sup>74</sup>.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**8.6** Komisioni, pasi administroi dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit, si dhe e dëgjoi në seancën dëgjimore, çmon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse dhe të plota dhe

<sup>73</sup>Shihni me detaje shpjegimet e subjektit të sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

<sup>74</sup>(a) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2016, e Bashkisë Korçë; (b) certifikatë përdorimi nr. \*\*\* prot., leje përdorimi; (c) certifikatë pronësie datë 8.9.2015; (ç) procesverbal kolaudimi datë 25.8.2016; (d) leje ndërtimi nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2016; (dh) situacion punimesh lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*\*” sh.p.k.; (e) planvendosje dhe planimetri.

provoi me dokumentacion që nuk kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të investuar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj. Nga shpjegimet e dhëna dhe dokumentacioni i përfituar gjatë hetimit administrativ rezultoi se kjo pasuri është përfituar nga shtetasja I. P. me një format ligjor të parashikuar nga Kodi Civil me trashëgimi dhe më pas me pjesëtim vullnetar. U provua që bashkëshorti i subjektit E. K. është shkëputur nga trangu familjar i shtetasës I. P. që në vitin 2005 kur ishte beqar. Më pas ai ka lidhur martesë me subjektin dhe kanë jetuar në Tiranë. U provua se shtetasja I. P. në përbërje familjare të saj është me djalin tjetër nga martesa e dytë, N. Dh. dhe bashkëshorten e tij. Subjekti ka depozituar dokumentacionin e rikonstruksionit të banesës miratuar nga Bashkia Korçë, si dhe ka depozituar edhe dokumentacionin ligjor të burimit me të cilin është bërë investimi i kësaj ndërtese (shitja e një shtëpie, kreditë e përmendura më lart).

**Komisioni, përtej çdo dyshimi për ndonjë pasuri të fshehur të subjektit apo dhe personit të lidhur me të/bashkëshortit, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit apo edhe bashkëshorti i saj nuk kanë lidhje me këtë pasuri qoftë në pronësi, qoftë në investim dhe, për rrjedhojë, nuk kemi të bëjmë me pasuri të fshehur në ngarkim të tyre.**

## **9. Analiza financiare për vitet 2004 – 2016**

Nga analiza e deklaratave të interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe asaj *Vetting* për periudhën e hetimit 2004 – 2016 të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën - 9,077,558 lekë për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**9.1** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj, përveç sa u trajtua më sipër në kriterin e pasurisë, ka kundërshtuar edhe balancën negative në shumën -152,752 lekë për vitin 2007, duke arsyetuar se sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së, shpenzimet për frymë në vitin 2007 janë në vlerën 235,968 lekë, vlerë e cila është dyfish në krahasim me vitet 2006 dhe 2008. Në praktikën e Komisionit vlera e shpenzimeve për frymë merret e barabartë me vitin 2008.

**9.2** Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me balancën negative për vitin 2007 nuk qëndrojnë dhe, për këtë arsye, nuk merren në konsideratë nga Komisioni.<sup>75</sup> Autoriteti i vetëm i specializuar për të përcaktuar është INSTAT-i, shkresës së të cilit i është referuar edhe Komisioni.

**9.3** Komisioni, pasi pasqyroi në analizë ndryshimet si në vijim: (i) marrjen në konsideratë si pagesë për vitin 2011 vetëm të një mandati prej 35,000 euro; dhe (ii) përfshirjen e shumës 28,000 euro të dhënë hua nga shtetasi K. P. në vitin 2011 – kreu analizën financiare të rishikuar, nga ku

---

<sup>75</sup>Shihni paragrafin 18.1, vendimi nr. 25/2021 (JR), datë 29.7.2021, subjekti i rivlerësimit A. Y. Komisioni i ka përlllogaritur shpenzimet e jetesës për vitin 2007 sipas të dhënave të vitit 2006, duke zhvlerësuar standardet e raportuara nga institucioni i specializuar INSTAT dhe të përdorura ndër vite, me arsyetimin se vlera e përlllogaritit është “dukshëm jo e saktë”, pasi duhet të ishte nën nivelin e vlerave zyrtare, të përcjella nga INSTAT-i ILDKPKI-së ndër vite. Kjo zgjedhje e Komisionit, në rastin e subjektit, bie ndesh me mënyrën e vlerësimit të këtij zëri shpenzimesh, të konsoliduar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit.



subjekti dhe bashkëshorti i saj rezultoi më balancë negative, përkatësisht në shumën 152,752 lekë për vitin 2007 dhe në shumën 256,542 lekë për vitin 2015.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh, si vijon:

- i) në datën 14.5.2006 (blerja e automjetit “Opel Corsa”) – balanca negative 82,856 lekë;
- ii) për vitin 2007 – balanca negative e burimeve 152,752 lekë;
- iii) në datën 25.7.2013 (pagesa e këstit të apartamentit prej 4,600 euro) – balanca negative 150,324 lekë;
- iv) në datën 27.3.2015 (blerja e automjetit “Daimler Chrysler”) – balanca negative 411,089 lekë;
- v) për vitin 2015 – 256,542 lekë.

Periodha	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>0</b>	<b>34,863</b>	<b>365,854</b>	<b>-21,491</b>	<b>-83,637</b>	<b>2,568</b>	<b>500,441</b>	<b>4,878,084</b>	<b>-299,473</b>	<b>673,094</b>	<b>469,703</b>	<b>953,689</b>	<b>3,540,579</b>
Apartament Rr. "****" 101 m2								4,897,550	152,295	644,920		420,900	3,465,000
Automjet Opel Corsa me targa **** dt.14.5.2006			250,000			-250,000							
Automjet Ford Focus me targa **** dt.19.10.2009						250,000							-250,000
Automjet Damlerschrysler me targa **** dt.27.3.2015												966,654	
7/252 pjesë e pandarë e pasurisë selishtë me sip 12,000 m2 ****													
<b>DIFERENCE LIKUIDITETI (LIK. AKTUAL - LIKUIDITETI)</b>	<b>0</b>	<b>34,863</b>	<b>115,854</b>	<b>-21,491</b>	<b>-83,637</b>	<b>2,568</b>	<b>500,441</b>	<b>-19,466</b>	<b>-451,768</b>	<b>28,174</b>	<b>469,703</b>	<b>-183,865</b>	<b>75,579</b>
LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT	0	0	34,863	150,717	129,226	45,589	48,157	548,597	529,131	77,363	105,537	575,240	391,375
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	0	34,863	150,717	129,226	45,589	48,157	548,597	529,131	77,363	105,537	575,240	391,375	466,954
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4,617,690</b>	<b>-699,650</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3,170,678</b>
Hua marrë **** 28,000 Euro								3,918,040					-135,270
Hua marrë **** 5,000 Euro								699,650	-699,650				
Kredi **** 25,000 euro dt.8.3.2016													3,305,948
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>0</b>	<b>34,863</b>	<b>365,854</b>	<b>-21,491</b>	<b>-83,637</b>	<b>2,568</b>	<b>500,441</b>	<b>260,394</b>	<b>400,177</b>	<b>673,094</b>	<b>469,703</b>	<b>953,689</b>	<b>369,900</b>
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	<b>537,603</b>	<b>773,592</b>	<b>1,088,424</b>	<b>1,084,501</b>	<b>1,343,011</b>	<b>1,381,180</b>	<b>1,459,529</b>	<b>1,511,840</b>	<b>1,486,879</b>	<b>1,447,110</b>	<b>1,778,294</b>	<b>1,859,010</b>	<b>1,909,834</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	537,603	773,592	792,639	544,871	648,415	807,623	827,717	835,428	797,358	778,789	1,076,071	1,138,821	1,175,732
Të ardhura nga paga e b/sh	0	0	295,785	539,630	694,596	573,557	631,812	648,287	662,666	668,321	702,223	715,189	734,102
Të ardhura nga interesat bankare								28,125	26,855				
Të ardhura nga shitja e mjetit												0	
Shpërblim për fëmijën												5,000	
<b>SHPENZIME</b>	<b>91,932</b>	<b>479,114</b>	<b>519,114</b>	<b>1,258,744</b>	<b>1,009,860</b>	<b>759,860</b>	<b>709,860</b>	<b>1,104,120</b>	<b>1,042,216</b>	<b>714,096</b>	<b>957,053</b>	<b>1,161,863</b>	<b>1,530,049</b>
Shpenzime jetike	46,932	219,114	219,114	658,744	409,860	409,860	409,860	409,860	534,716	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi		0	0	-	-	-	0	304,260	-	-	77,061	150,994	427,659
Shpenzime mobilimi				300,000	300,000			90,000	220,000	150,000			
Humbje nga shitja e mjetit						50,000							
Shpenzime qiraje	45,000	260,000	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000	287,500				
Shpenzime shkollimi për b/sh												100,000	
Shpenzim kredie													148,496
Shpenzime shëndetëore												13,765	13,527
<b>LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT</b>	<b>0</b>	<b>34,863</b>	<b>150,717</b>	<b>129,226</b>	<b>45,589</b>	<b>48,157</b>	<b>548,597</b>	<b>529,131</b>	<b>77,363</b>	<b>105,537</b>	<b>575,240</b>	<b>391,375</b>	<b>466,954</b>
Cash											500,000	300,000	400,000
Llogari page R*** ****		34,863	120,237	50,014	10,786	184	19	19	19	19	19	19	19
Llogari depozite ****								1	81	81	81	81	81
Depozite ****							500,000	528,125	0				
Llogari page C*** ****							22	128	23,353	50,881	461	584	49
Llogari page C*** ****						47,843	48,556	858	48,910	54,556	74,679	85,691	58,690
Llogari rrjedhëse ****												5,000	5,000
Llogari page A*** ****				78,789	34,803	129	0						
Llogari page A*** ****			30,480	423	0								
Llogari bebi ****									5,000	0			
Llogari rrjedhëse bashkëmërore ****													3,115
Analiza dokumentuar	445,671	259,615	203,456	-152,752	416,788	618,752	249,228	147,326	44,486	59,920	351,539	-256,542	9,885

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**10.** DSIK-ja, pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.9.2022, ka dërguar pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit Antonela Prendi, deklasifikuar plotësisht (me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.9.2022, të KDZH-së) dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se:

*i) Formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.*

*ii) Për subjektin e rivlerësimit Antonela Prendi nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Antonela Prendi.

**10.1** Nga përditësimi i informacionit me institucione të tjera ligjzbatuese, Komisioni ka vijuar hetimin në lidhje me kriterin e figurës, nga ku është konstatuar si vijon:

Komisioni, bazuar në hetimin administrativ dhe shpjegimet e subjektit, arriti në përfundimin se të dhënat e referuara nga organet ligjzbatuese nuk provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo dhe kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë).

**Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konfirmuar kështu përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Antonela Prendi.**

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**11.** Rivlerësimi profesional, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) si organi ndihmës për vlerësimin profesional dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2022, për subjektin e rivlerësimit Antonela Prendi.

**11.1 Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:**

- i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- ii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- iii) denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

**11.2** Në raportin e Komisionit të Vlerësimit pranë KLGJ-së për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar:

- aftësi të mira profesionale (ku përfshihen njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor);
- aftësi të mira organizative (ku përfshihen aftësia për të përballuar ngarkesën në punë);
- aftësia për të kryer procedurat gjyqësore dhe aftësia për të administruar dosjet);
- etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale (ku përfshihen etika në punë, integriteti dhe paaënësia);
- aftësitë personale e angazhimi profesional (ku përfshihen aftësisë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar dhe gatishmëria për t'u angazhuar).

### **11.3 Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotësuar sipas shtojcës së ligjit, me saktësi, me shkrim të qartë e të lexueshëm dhe është nënshkruar rregullisht në çdo faqe.

### **11.4 Tri dokumentet ligjore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit**

**Dokumenti 1** – vendimi gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 23.9.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket çështjes civile me nr. regj. them. \*\*\*<sup>76</sup>. Në këtë çështje subjekti ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Nga të dhënat e vendimit nuk mund të përcaktohet nëse ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga palët në Gjykatën e Apelit Tiranë. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar<sup>77</sup>.

**Dokumenti 2** – vendimi gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 30.7.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket çështjes civile me nr. regj. them. \*\*\*<sup>78</sup>. Në këtë çështje subjekti ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Nga të dhënat e vendimit nuk mund të përcaktohet nëse ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga palët në Gjykatën e Apelit Tiranë. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

**Dokumenti 3** – vendimi gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 7.6.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket çështjes civile me nr. regj. them. \*\*\*<sup>79</sup>. Në këtë çështje subjekti ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Nga të dhënat e vendimit nuk mund të përcaktohet nëse ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga palët në Gjykatën e Apelit Tiranë. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

**Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLGJ-së dhe pas analizimit të tri dokumenteve nga Komisioni, nuk konstatohen problematika lidhur me vlerësimin e kriterit profesional.**

---

<sup>76</sup>Që u përket palëve: paditës F. Gj., të paditur shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k. etj., me objekt "vërtetimi i mosqenies së marrëdhënies juridike të kontratës së hipotekimit dhe konstatimin pjesërisht të pavlefshëm të kontratës së hipotekimit nr. \*\*\*, datë 17.5.2012 etj."

<sup>77</sup>Në këtë vendim janë parashtruar faktet dhe rrethanat, shpjegimet e palëve ndërgjyqëse, përmbajtja e provave të shqyrtuara nga subjekti, parashtrimin e pretendimeve, kërtimeve, argumenteve ligjore të secilës palë, është pasqyruar me saktësi konkluzioni i arritur nga gjykata në pjesën arsyetuese-përshkruese. Disponohet gjithashtu për pagesën e shpenzimeve gjyqësore, tregohet e drejta e palëve për të ushtruar ankim në gjykatat më të larta. Vendimi është i strukturuar, janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

<sup>78</sup>Që u përket palëve: paditës A. F., kundër të paditurve E. H. etj., me objekt "pavlefshmëri absolute e kontratës së hipotekës nr. \*\*\*, datë 9.9.2009, në lidhje me apartamentin nr. \*\*\*, me sip. 143.9 m<sup>2</sup> etj."

<sup>79</sup>Që u përket palëve: kërkues N. K., person i tretë shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k., me objekt "hapje e procedurave të falimentimit për subjektin shoqëria "\*\*\*\*" etj.; caktimi i një administratori të përkohshëm falimentimi".

## 11.5 Pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura me short

**Dosja 1** – çështja civile nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 2.10.2014 regjistrimi<sup>80</sup>, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.4.2015, ku subjekti ka gjykuar si gjyqtare e vetme.

Dosja gjyqësore dhe vendimi janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në respektim të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 6 muaj e 18 ditë, në tejkalim me 18 ditë të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Nuk konstatohen mangësi në menaxhimin e çështjes nga ana e subjektit, të cilat të jenë bërë shkak për tejkalimin e afatit standard të gjykimit. Në procesverbalin gjyqësor janë pasqyruar të plota vendimet e ndërmjetme, si dhe dispozitivi i vendimit përfundimtar. Vendimi i mësipërm përmbush standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

**Dosja 2** – çështja civile nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 12.11.2014 regjistrimi<sup>81</sup>, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.6.2015, ku subjekti ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 2.7.2015, pas 1 muaji nga shpallja, duke shkëlur afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 6 muaj e 19 ditë, duke tejkaluar me 19 ditë afatin standard 6-mujor. Tejkalimi i afatit standard të gjykimit në rastin konkret vlerësohet i papërfillshëm. Janë planifikuar dhe zhvilluar gjithsej 12 seanca, të cilat ishin produktive. Vendimi i mësipërm përmbush standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

**Dosja 3** – çështja civile nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 28.10.2015 regjistrimi<sup>82</sup>, gjykuar nga subjekti si gjyqtar i vetëm. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 23.12.2015, janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në respektim të afatit 10-ditor. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 muaj e 23 ditë, në respektim të afatit standard 2-mujor. Vendimi i mësipërm përmbush standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, që i korrespondon zgjidhjes së një çështjeje civile pa palë kundërshtare.

**Dosja nr. 4** – çështja civile nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 6.11.2015 regjistrimi<sup>83</sup>, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.6.2016, ku subjekti ka gjykuar si gjyqtar i vetëm. Dosja gjyqësore dhe vendimi janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në

<sup>80</sup>Që u përket palëve: paditës S. S., kundër të paditurit “\*\*\*\*” sh.a., me objekt “shpërblimi i paditësit me pagën e 27 muajve, për zgjidhjen e marrëdhënies së punës për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin...”. Subjekti, në cilësinë e gjyqtares së çështjes, ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur “\*\*\*\*” sh.a., të dëmshpërblejë [...] etj.”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe është kundërshtuar nga pala e paditur në Gjykatën e Lartë, çështja është regjistruar por nuk është disponuar ende me vendim.

<sup>81</sup>Që u përket palëve: paditëse N. D., kundër të paditurit DRSSH Tiranë, me objekt “njohjen e vërtetësisë së dokumentit librezë pune lëshuar nga NBSH ‘Gj. D.’, sek. II, \*\*\*, datë 1.10.1968, në lidhje me: emrin, N. D., etj.”, ku subjekti, në cilësinë e gjyqtares së çështjes, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Deklarimin e pavërtetësisë së dokumentit librezë pune e paditëses [...] etj.”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.6.2016. Ky vendim është kundërshtuar nga pala e paditur në Gjykatën e Lartë, çështja është regjistruar por nuk është disponuar ende me vendim.

<sup>82</sup>Që u përket kërkuessve S. B. dhe P. A., person i tretë AKKPronave Tiranë, me objekt “rivendosjen në afat të së drejtës për të kërkuar pranë AKKP Tiranë njohjen e pronësisë dhe ose kthimin etj., gjykuar nga subjekti si gjyqtar i vetëm” dhe në përfundim të gjykimit ka vendosur: “Pranimin e kërkesës. Rivendosjen e kërkuessve S. B. dhe P. A. në afatin e paraqitjes së kërkesës për njohjen, kthimin dhe/ose kompensimin e pronave të subjekteve të shpronësuara A. dhe Xh. A. pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave [...] etj.”. Rezultoi se vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë pa u ankuar.

<sup>83</sup>Ku subjekti ka gjykuar si gjyqtare e vetme dhe në përfundim të gjykimit është vendosur: “Rrëzimi i kërkesëpadisë”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.5.2019. Ky vendim është kundërshtuar nga pala e paditur në Gjykatën e Lartë, çështja është regjistruar por nuk është disponuar ende me vendim.

Si konkluzion, pavarësisht cenimit të vendimit nga një gjykatë më e lartë në aspektin formal, arsyetimi i vendimit të mësipërm nga gjyqtarja Antonela Prendi, është korrekt dhe përmbush të gjitha standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

datën 28.7.2016, pas 1 muaji nga shpallja, duke shkelur afatin 10-ditor. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 7 muaj e 16 ditë, në shkelje të afatit standard 6-mujor. Nisur nga shkaqet e shtyrjes së seancave, rezultoi se shkelja e afatit standard të gjykimit ka ardhur për shkak të pamundësisë së njoftimit të të paditurit. Nuk gjenden shkaqe për zvarritje të gjykimit nga gjyqtarja Prendi, ashtu sikurse nuk konstatohen as shtyrje të pajustificuar të seancave të zhvilluara prej saj.

**Dosja 5** – kërkesa penale nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 18.11.2013 regjistrimi<sup>84</sup>, përfunduar me vendimin e datës 18.11.2013, gjykuar nga subjekti si gjyqtare e vetme. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës në respektim të afatit 5-ditor. Gjykimi i çështjes është realizuar në respektim të afatit 48 orë të përcaktuar nga neni 259, pika 5 e Kodit të Procedurës Penale. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar, të përcaktuar nga neni 28, pika 2 e Kushtetutës dhe neni 5, pika 3 e KEDNJ-së. Vendimi përmbush standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

**Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLGJ-së dhe pas analizimit të pesë dosjeve të hedhura në short, nuk konstatohen problematika lidhur me vlerësimin e kriterit profesional.**

## **11.6 Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së**

**11.6.1** Sipas të dhënave në databazën e ankesave, rezulton se gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, për subjektin Antonela Prendi janë paraqitur 6 ankesa<sup>85</sup> pranë ish-KLD-së, ku 3 prej të cilave janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak, me arsyetimin se 2 prej tyre (1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta dhe 1 e vitit 2015, me arsyetimin se është ankesë e përsëritur më parë. Dy ankesa janë verifikuar dhe ka rezultuar si vijon: (i) 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar për mosdorëzimin në afat të vendimeve të arsyetuara i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik; (ii) 1 ankesë e vitit 2016 verifikuar për zvarritje i është dërguar ILD-së në proces verifikimi; (iii) 1 ankesë e vitit 2016 verifikuar për mosrespektim formal ligji i është dërguar ILD-së në proces verifikimi.

**11.6.2** Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Antonela Prendi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli.

## **11.7 Të dhëna nga prokuroritë**

**11.7.1** Prokuroria e Përgjithshme<sup>86</sup>, në lidhje me subjektin e rivlerësimit, i ka përcjellë Komisionit përgjigjet e prokurorive për informacion në lidhje me kallëzime, procedime penale apo kërkesa për gjykim.

---

<sup>84</sup>Që i përket kërkesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit O. B., të dyshuar për kryerjen e veprës penale ‘drejtimit i mjetit në gjendje të parregullt’, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal etj.”, subjekti si gjyqtare e vetëm ka vendosur: “Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim O. B. Caktimin e masës së sigurimit personal [...] etj.”. Rezultoi se vendimi i mësipërm mori formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

<sup>85</sup>Dy ankesa të vitit 2014, dy të vitit 2015 dhe dy të vitit 2016.

<sup>86</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme.

**11.7.2** Prokuroritë e rretheve gjyqësore<sup>87</sup> kanë konfirmuar se pranë tyre nuk rezulton të jenë depozituar kallëzime apo procedime në ngarkim të subjektit Antonela Prendi.

**11.7.3** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan<sup>88</sup> ka konfirmuar se Prokuroria e Përgjithshme, në datën 23.1.2019, ka përcjellë për kompetencë pranë saj kallëzimin e shtetasit A. B., ku ky shtetas ka bërë kallëzim ndaj disa gjyqtarëve, përfshirë edhe subjektin Antonela Prendi. Në materialin kallëzues është regjistruar procedim penal nr. \*\*\*, datë 7.2.2019, për veprën penale të parashikuar nga nenet 248 dhe 186/3 të Kodit Penal dhe nuk ka të regjistruar persona nën hetim. Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 7.2.2019, është dërguar për kompetencë pranë Prokurorisë së Posaçme (në vijim PPKKKO).

**11.7.4** PPKKKO-ja<sup>89</sup> konfirmon se për kallëzimin e shtetasit A. B. procedimi penal është pa asnjë emër të regjistruar. Pas kryerjes së hetimeve për këtë procedim është vendosur të dërgohet në gjykatë me kërkesë për pushim me datë 8.7.2022. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.2022, Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur pushimin e këtij procedimi.

**11.7.5** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>90</sup> konfirmon se pranë saj është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, i regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, për veprën penale “shpërdorim detyre”, pa autor, i cili i është dërguar gjykatës me kërkesë për pushim me datë 4.7.2019. Aktualisht çështja është në hetim pasi është kthyer nga gjykata për veprime.

Komisioni ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>91</sup>, e cila konfirmon se në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\* kjo çështje penale është aktualisht në fazën e hetimeve.

**11.7.6** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>92</sup> konfirmon se pranë saj janë regjistruar tri materiale kallëzimi për subjektin e rivlerësimit Antonela Prendi, për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe pas veprimeve hetimore Prokuroria ka vendosur mosfillimin e këtyre procedimeve<sup>93</sup>.

## **11.8 Denoncime/ankesa nga publiku**

Për subjektin e rivlerësimit Antonela Prendi janë depozituar 20 denoncime/ankesa nga publiku, si vijon:

---

<sup>87</sup>Shkresa nga prokuroritë e rretheve gjyqësore: Krujë me nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2021; Kavajë me nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2021; Pukë me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Berat me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Mat me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Kurbin me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Tropojë me nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; Përmet me nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; Gjirokastrë me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Kukës me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Fier me nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021; Sarandë me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Korçë me nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021; Shkodër me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Pogradec me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Dibër me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Lezhë me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Lushnjë me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Vlorë me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021.

<sup>88</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>89</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022, e PPKKKO-së.

<sup>90</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>91</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>92</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>93</sup>(i) Materiali kallëzues i procedimit penal nr. \*\*\*/2019, ku shtetasi A. B. ndaj 14 subjekteve (gjyqtarë dhe prokurorë), përfshirë edhe subjektin Antonela Prendi, për veprën penale “shpërdorim detyre”. Në përfundim të hetimit prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal; (ii) materiali kallëzues nr. \*\*\*/2018, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit G. Sh. ndaj dy gjyqtarëve, ku njëra ishte subjekti Antonela Prendi, për veprën penale “shpërdorim detyre”. Në përfundim të hetimit prokuroria vendosi mosfillimin e procedimit penal; (iii) materiali kallëzues nr. \*\*\*/2016, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasi G. Sh. ndaj subjektit Antonela Prendi dhe në përfundim të hetimit prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

### 11.8.1 Për denoncimet e mëposhtme:

**i) nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2017, i subjektit “\*\*\*\*”,** i cili i kërkon Komisionit të hetojë zhdukjen e dokumentacionit nga dosja gjyqësore e tij të dorëzuara në një seancë kur çështja gjykohej nga gjyqtarja R. V. Në këtë ankesë subjekti i rivlerësimit Antonela Prendi është për dijeni dhe është gjyqtarja së cilës i është caktuar më vonë kjo çështje për gjykim.

**ii) nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2018, i shtetasit A. K.,** i cili ngre ankesë ndaj subjektit Antonela Prendi, duke pretenduar se ajo ka marrë vendim të padrejtë, abuziv dhe të njëanshëm, duke zhvilluar gjykim pa prezencën e palës së paditur. Denoncuesi nuk ka referuar vendim konkret të dhënë nga subjekti i rivlerësimit Antonela Prendi për shkeljet e pretenduara nga ana e saj.

**iii) nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2018 dhe \*\*\* prot., datë 12.4.2018, i shtetasit S. H.,** i cili pretendon se nga ana e gjyqtarëve M. K., F. B. dhe Antonela Prendi, që kanë gjykuar në një trupë gjyqësore me 3 gjyqtarë, kanë dhënë një vendim të padrejtë në favor të palës kundërshtare. Denoncuesi nuk ka depozituar vendim konkret, për të cilin ngre pretendime, dhe as nuk ka referuar shkelje konkrete për subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi i referohet vendimmarrjes së padrejtë të trupës ku subjekti ka qenë pjesë e saj.

**iv) nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2018, i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.,** e cila pretendon se subjekti Antonela Prendi si gjyqtare e çështjes ka shtyrë seancat në mënyrë të vazhdueshme për të ndihmuar palën tjetër tej çdo afati normal. Ajo ka favorizuar palën tjetër gjatë shqyrtimit të çështjes. Denoncuesi nuk ka bashkëlidhur asnjë dokument ligjor në lidhje me këtë çështje. Në denoncimin e saj shoqëria nuk sqaron se cilët janë palët në gjykim, cili është objekti i gjykimit dhe nuk ka identifikuar apo referuar ndonjë vendim të marrë në fund të këtij procesi.

**v) nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2019, i shtetasit I. C.,** i cili ngre ankesë për prokuroren D. S. për hetime të parregullta dhe për subjektin e rivlerësimit Antonela Prendi pretendon se ka favorizuar palën kundërshtare dhe nuk ka marrë parasysh prova lidhur me vendimmarrjen. Pretendon se ka dyshime që avokatja mbrojtëse e tij dhe e palës tjetër kanë bashkëpunuar me gjyqtaren në mënyrë që të mos ankimonte vendimin. Denoncuesi ka bashkëngjitur vetëm një vendim pushimi të prokurores D. S., por nuk ka referuar apo bashkëlidhur ndonjë vendim gjykate në mënyrë që ta lidhë me subjektin e rivlerësimit.

**vi) nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2019 (i përcjellë nga IKP-ja) i shtetasit A. B.,** i cili ka depozituar një kallëzim penal kundër 30 gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë edhe subjektin Antonela Prendi. Në brendësi të kallëzimit të tij ankuesi nuk referon ndonjë rrethanë konkrete në lidhje me subjektin Antonela Prendi.

**vii) nr. \*\*\* prot., datë 11.6.2021, i studios ligjore “\*\*\*\*”, përfaqësues i A. A. etj.,** e cila pretendon se në momentin e depozitimit të denoncimit kjo çështje ka qenë në hetim nga gjyqtarja Antonela Prendi dhe prej saj janë marrë një seri veprimesh të cilat kanë cenuar procesin e rregullt ligjor dhe kanë qenë favorizuese për palën tjetër. Komisioni ka administruar përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>94</sup>, e cila konfirmon se pranë kësaj gjykate është regjistruar çështja civile me nr. \*\*\* regj., datë 6.11.2020, me palë paditëse G. dhe E. M. dhe

<sup>94</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 14.11.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



palë e paditur shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. etj., me objekt “njohje pronar”, dosje e cila ndodhet për shqyrtim pranë gjyqtarës A. K.

**viii) nr. \*\*\*\* prot., datë 15.12.2022, e shtetasit L. A.,** i cili ka depozituar pranë Komisionit dokumentin “kallëzim penal” drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për dijeni Komisionit etj., në ngarkim të gjyqtarës Antonela Prendi për veprën penale “shpërdorim detyre”. Shtetasi L. A. pretendon se nga gjyqtarja Antonela Prendi, e cila ka në gjykim një çështje ku denoncuesi është palë, ka pranuar të shqyrtojë një kërkesëpadi të pabazuar në prova shkresore dhe me të meta dhe po favorizon palën paditëse dhe me këto veprime, si rrjedhim denoncuesi pretendon se është në kushtet shpërdorimit të detyrës nga ana e gjyqtarës.

**Komisioni, pas verifikimit të denoncimeve të lartpërmendura, arrin në përfundimin se ato nuk plotësojnë kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi denoncuesit nuk ka referuar rrethana konkrete, praktika apo veprime specifike që të krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit.**

**11.8.2** Për denoncimet e mëposhtme:

**i) nr. \*\*\*\* prot., datë 28.5.2018, i shtetasit P. X.,** i cili ka pretenduar se nga gjyqtarja Antonela Prendi është bërë korrupsion dhe ka dhënë vendim në kundërshtim me ligjin. Denoncuesi ka bashkëngjitur vendimin nr. \*\*\*\* akti, datë 17.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i dhënë nga subjekti Antonela Prendi, si dhe vendimin nr. \*\*\*\*, datë 13.7.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*\* akti, datë 17.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ii) nr. \*\*\*\* prot., datë 27.4.2018, nr. \*\*\*\* prot., datë 26.7.2018 dhe nr. \*\*\*\* prot., datë 7.7.2020 (i përcjellë nga IKP-ja), të shtetasit D. N.,** i pretendon se nga subjekti Antonela Prendi janë kryer shkelje të rënda procedurale referuar vendimit të marrë nga subjekti për vleftësimin e masës së sigurimit “arrest me burg” në ngarkim të denoncuesit D. N.. Ai pretendon se subjekti i rivlerësimit është mjaftuar vetëm me paraqitjen e akuzës dhe provave të pavërtetuara nga ana e organit procedues. Nga ana e subjektit nuk u realizua as procesi i çmuarjes së provave në përputhje me nenin 152 të Kodit Penal etj.

**iii) nr. \*\*\*\* prot., datë 27.12.2018 i (i përcjellë nga Kolegji), i shtetasit B. S.,** i cili ngre pretendime për 3 gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfshirë edhe subjektin Antonela Prendi, pasi kanë qenë të njëanshëm drejt palës së paditur duke i favorizuar. Denoncuesi ka bashkëlidhur edhe dy vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit.

**iv) nr. \*\*\*\* prot., datë 27.5.2020, i shtetasit A. N.,** i cili ngre pretendime për disa gjyqtarët që kanë gjykuar çështjet ku ai ka qenë palë, përfshirë edhe subjektin Antonela Prendi se kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe kanë dhënë vendime të padrejta. Denoncuesi ka bashkëlidhur vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Apelit për çështjen ku ai ka qenë palë në proces.

**v) nr. \*\*\*\* prot., datë 28.2.2020, i shtetasit D. H.,** i cili ka depozituar një rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë gjykuar nga subjekti Antonela Prendi dhe ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë i cili ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë gjykuar nga trupa gjyqëse e përbërë nga gjyqtarët E. T., G. L. dhe E. Ll.

Denoncuesi nuk ka bashkëngjitur asnjë nga vendimet e sipërcituara, por në fillim të dokumentit rekurs ngre pretendime për vendime të padrejta të dhëna nga subjekti Antonela Prendi në gjykimin në shkallë të parë dhe ndaj 3 gjyqtarëve që kanë gjykuar në Gjykatën e Apelit, por denoncuesi nuk ka referuar shkelje konkrete për subjektin e rivlerësimit.

**vi) nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2019, i shtetases A. Q.,** e cila pretendon për gjyqtaren Antonela Prendi se ka dhënë vendim të kundërligjshëm, duke i rrëzuar padinë e ngritur prej saj. Denoncuesja i ka bashkëlidhur denoncimit disa vendime gjyqësore të proceseve që ajo ka pasur.

**vii) nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2019, i shtetasit A. Q.,** i cili pretendon se vendimi i shkallës së parë i dhënë nga subjekti Antonela Prendi dhe ai i Gjykatës së Apelit i dhënë nga gjyqtarët F. I., M. Q. dhe A. V. janë vendime haptazi të njëanshme dhe me shkelje të rënda të ligjit procedural dhe material.

**Komisioni, pasi analizoi denoncimet e lartpërmendura, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur në to, vëren se nga ana e denoncuesve nuk janë referuar shkelje procedurale konkrete, por ata kanë ngritur pretendime për vendime të padrejta. Komisioni vëren se duke referuar vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, denoncimet kanë të bëjnë me themelin e çështjes, ku në këto raste Komisioni mban parasysh nenin 72 të ligjit nr. 96/2016.**

**11.8.3 Denoncimet nr. \*\*\* prot, datë 15.10.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2021, të shtetases K. Ç. (2 të tilla),** e cila ngre pretendime për vendimmarrje jo të drejtë dhe se gjykimi ka zgjatur 2 vjet. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit disa vendime gjykatash, ndër to edhe një vendim të dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni, pasi analizoi vendimin nr. \*\*\* akti dhe nr. \*\*\* , datë 23.2.2015, të marrë nga subjekti Antonela Prendi lidhur me pretendimin e denoncueses për zgjatje të gjykimit të çështjes për rreth 2 vjet, ka administruar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [www.gjykatatirana.gov.al](http://www.gjykatatirana.gov.al) detajet e çështjes civile nr. \*\*\* , datë regjistrimi 24.7.2013 dhe rezulton se janë zhvilluar 25 seanca gjyqësore, duke filluar me seancën e datës 14.10.2013 dhe ka përfunduar me seancën e shpalljes së vendimit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit me datë 23.2.2015. Ndaj këtij vendimi denoncuesja ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. \*\*\* , datë 23.2.2015 vendosi: “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\* , datë 23.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Bazuar në përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>95</sup> rezulton se çështja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Lartë, e cila nuk është shprehur ende me një vendim.

**11.8.3.1** Komisioni ka konstatuar se gjykimi i çështjes gjyqësore ka zgjatur rreth 18 muaj, në tejkallim të afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Për këtë konstatim subjektit iu kërkua të japë shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**11.8.3.2** Subjekti në prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore ka dhënë të njëjtat shpjegime. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, subjekti ka administruar dosjen nga Gjykata

---

<sup>95</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 14.11.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

e Lartë dhe ka shpjeguar se dosja fillimisht me short, me datë 24.7.2013, iu caktua gjyqtarit A.K. Pasi ky i fundit hoqi dorë nga gjykimi çështja u hodh përsëri në short dhe në datën 24.10.2013 iu caktua për gjykim subjektit Antonela Prendi. Kohëzgjatja e gjykimit është diktuar nga shkaqe procedurale si mungesa e dijenisë për një pjesë të seancave gjyqësore nga i padituri, paditësi, kërkesat e palëve për t'u mundësuar përfaqësimi me avokat, kërkesat e paditëses për paraqitjen e provave të reja, kërkesa për shtyrje gjykimi nga palët etj., por edhe nga kompleksiteti i çështjes<sup>96</sup>.

**11.8.3.3** Komisioni, pasi administroi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe pasi e dëgjoi në seancë dëgjimore, çmon se subjekti ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse. Subjekti ka shpjeguar me detaje shtyrjet e çdo seance, nga ku ka ardhur si pasojë dhe zgjatja e procesit gjyqësor për rreth 18 muaj. Komisioni vëren se zgjatja e gjykimit jashtë standardit të miratuar nuk ka ardhur për shkaqe subjektive të subjektit, por për shkaqe objektive procedurale nga ana e palëve, ashtu edhe nga kompleksiteti i çështjes në fjalë dhe subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore për kriterin profesional.

#### **11.8.4 Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2023, të shtetasit L. B.**

Shtetasi L. B., në datën 25.1.2023, një ditë përpara seancës dëgjimore që i ishte caktuar subjektit të rivlerësimit me datë 26.1.2023, ka depozituar pranë Komisionit një denoncim ndaj subjektit Antonela Prendi, ku ka pretenduar se:

- *Dhënia e konkluzioneve përfundimtare nga palët u zvarrit pa asnjë shkak nga marsi 2022 deri në shtator 2022.*
- *Shpallja e vendimit u zvarrit pa asnjë shkak të arsyeshëm nga 28.9.2022 deri më 6.12.2022 (pra 2 muaj e gjysmë).*
- *Arsyetimi i vendimit nuk është zbardhur ende.*
- *Në datën 10.10.2022 kërkua nga gjyqtarja të pajiseshim me kopje të procesverbaleve të seancave, si dhe me regjistrimet audio të cilat nuk na janë vënë ende në dispozicion edhe pas përsëritjes së kërkesës në datën 6.12.2022.*
- *Nuk u njoftua për shpalljen e vendimit (sikurse pohohet prej vetë gjyqtarës me shkrimin dhe nënshkrimin e saj, ai vendim u shpall prej saj në zyrë pa u njoftuar avokatja ime).*
- *Në 4 vjet gjykim u caktuan 50 seanca gjyqësore, nga të cilat 5-6 seanca patën relevancë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.*
- *Nga ana e gjykatës u mor vendimi për mospranimin e kërkesës për shpallje moskompetence lëndore, ashtu për mosnxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionin gjyqësor.*

**11.8.4.1** Komisioni, në datën 25.1.2023, me anë të postës elektronike, menjëherë i njoftoi subjektit se ka riçelur hetimin administrativ në lidhje me këtë denoncim dhe se për pretendimet e denoncuesit subjekti të japë shpjegime dhe të depozitojë prova deri në seancën dëgjimore (përfshirë edhe seancën dëgjimore), bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>96</sup>Shihni në dosje shpjegimet e detajuara të dhëna nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni.

**11.8.4.2** Subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 26.1.2016 dha shpjegime dhe depozitoi prova mbështetëse. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar<sup>97</sup> se në të kundërt të pretendimeve të palës ankuese nuk ka pasur zvarritje në lidhje në administrimin e konkluzioneve përfundimtare. E vetmja shtyrje është diktuar nga kërkesa e palës paditëse për t'i dhënë edhe pak ditë kohë për të konkluduar në lidhje me qëndrimin e tij përfundimtar në çështje.

Në lidhje me pretendimin se shpallja e vendimit u zvarrit pa shkak të arsyeshëm nga data 28.9.2022 deri në 6.12.2022 subjekti ka shpjeguar se referuar procesverbaleve të seancës gjyqësore, shtyrjet kanë qenë tërësisht të justifikuar nga arsye objektive dhe mungesat kanë qenë të justifikuar përmes raporteve mjekësore dhe lejeve të miratuara nga Kryetari i Gjykatës.

Për pretendimin se arsyetimi i vendimit ende nuk është zbardhur, subjekti ka depozituar një kopje të zbardhur të vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 6.12.2022. Pas arsyetimit, vendimi i është dhënë sekretares gjyqësore në datën 26.12.2022 për vijimin e veprimeve administrative të qepjes së dosjes, numërtimit etj. Subjekti ka vënë në dispozicion kopje të librit të dorëzimeve.

Në lidhje me pretendimin se denoncuesit nuk i janë vënë në dispozicion kopje të procesverbaleve gjyqësore dhe CD audio, subjekti ka shpjeguar se kjo kërkesë e palës trajtohet nga sekretaria gjyqësore pasi është veprim me natyrë administrative dhe nuk është kompetencë e gjykatës bazuar në parashikimet e nenit 77 të Kodit të Procedurës Civile.

Në lidhje me pretendimin se nuk u njoftua për shpallje vendimi avokatja e denoncuesit, subjekti ka shpjeguar se sekretaria gjyqësore është kujdesur për njoftimin e të gjitha palëve ndërgjyqëse me fletëthirrje, kopje të të cilave subjekti i vuri në dispozicion të Komisionit. Njoftimi i është adresuar edhe të paditurit L. B., por nga konfirmimi i ftuesit gjyqësor në fletëthirrjen e datës 25.11.2022 ka shënimin “nuk gjendet në adresë”.

Në lidhje me pretendimin se nga ana e gjykatës nuk u mor vendim për mosnxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe u vendos rrëzimi i kërkesës për shpalljen e moskompetencës lëndore, subjekti ka shpjeguar se gjykata me vendim rrëzoi kërkesën e kërkuarit L. B., vendim i cili u ankimua nga ky i fundit në Gjykatën e Lartë, e cila vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së dhënë nga subjekti.

Në lidhje me pretendimin se gjatë kohëzgjatjes së gjykimit vetëm 5 seanca ishin relevante për gjykimin e çështjes, subjekti ka shpjeguar se ashtu sikurse konstatohet nga përmbajtja e vendimit të arsyetuar, ecuria e gjykimit me përjashtim të seancave gjyqësore ku vetë palët janë bërë shkak për shtyrjen e gjykimit në të gjitha seancat e tjera janë kryer veprime të domosdoshme procedurale, për më tepër dhe për shkak të kalendarit të ngarkuar të gjykimeve (1270 dosje çdo muaj për gjykim), fakt që ka diktuar artificialisht në kohëzgjatjen e gjykimit.

**11.8.4.3** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse. Për pretendimin e denoncuesit se dhënia e konkluzioneve është zvarritur, subjekti depozitoi si provë procesverbalet e seancave gjyqësore të datave 16.9.2022, 21.9.2022 dhe 28.9.2022, të cilët pasqyrojnë veprimet procedurale dhe afatet ligjore me të cilat është justifikuar edhe shtyrja e dorëzimit të konkluzioneve.

---

<sup>97</sup>Shihni me detaje shpjegimet e subjektit të depozituara në seancën dëgjimore të datës 26.1.2013.

Për pretendimin se u zvarrit shpallja e vendimit, subjekti ka depozituar procesverbalet e seancave gjyqësore të datave 18.10.2022, 28.10.2022, 11.11.2022 dhe 6.12.2022, të cilët pasqyrojnë edhe arsyet ligjore që kanë çuar në shtyrjen e shpalljes së vendimit.

Në lidhje me pretendimin se arsyetimi i vendimit nuk është zbardhur ende, subjekti ka depozituar një kopje të vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 6.12.2022, të zbardhur, i cili i është dhënë sekretares gjyqësore në datën 26.12.2022 për vijimin e veprimeve të mëtejshme, duke bashkëngjitur edhe kopje të librit të dorëzimeve.

Në lidhje me pretendimin për vënie në dispozicion të procesverbaleve gjyqësore dhe CD audio, në referencë të nenit 77 të Kodit të Procedurës Civile, ky është veprim administrativ që bëhet nga sekretaria gjyqësore dhe jo nga gjyqtari.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se nuk u njoftua për shpallje vendimi avokatja e tij, subjekti ka depozituar kopje të fletëthirrjes drejtuar shtetasit L. B., ku nga komunikimi i saj nga ftuesi i gjykatës rezulton se ai nuk ndodhej në adresë. Komisioni vëren se denoncuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë ligjore për shkak se e drejta e ankimit fillon nga momenti i komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Në lidhje me pretendimin se nga gjykata nuk u nxor jashtë juridiksionit për moskompetencë lëndore, subjekti depozitoi vendimin e gjykatës së datës 3.7.2019, të dhënë prej saj, ku ajo ka rrëzuar kërkesën e denoncuesit, si dhe vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 11.11.2020, i cili ka lënë në fuqi vendimin e dhënë nga subjekti.

Për pretendimin se gjatë gjithë kohëzgjatjes së gjykimit vetëm 5 seanca ishin relevante për gjykimin e çështjes, subjekti ka depozituar dokumentacionin e dosjes gjyqësore, që përfshin vendime për veprime paraprake, procesverbale të seancave gjyqësore etj.<sup>98</sup>, të cilët pasqyrojnë me detaje veprimet procedurale që janë kryer nga ana e gjykatës, të cilat kanë çuar në zgjatjen e procesit gjyqësor jo për shkaqe subjektive të subjektit por për shkaqe objektive.

**Komisioni arrin në përfundimin se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, pasi subjekti, në cilësinë e gjyqtarës së çështjes, është kujdesur të kryejë me korrektesë veprimet procedurale që lidhen më çështjen në fjalë. Komision vëren se nuk ka *indicie apo prova* që të ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.**

## KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim

---

<sup>98</sup>Vendime të veprimeve paraprake të datave 15.7.2019, 15.10.2019 dhe 13.11.2019; procesverbal i veprimeve përgatitore të datave 17.1.2019, 14.2.2020, 7.7.2020, 14.9.2020, 16.10.2020, 4.12.2020, 18.1.2021, 23.2.2021, 7.4.2021, 15.6.2021, 14.10.2021, 4.11.2021, 7.12.2021, 21.12.2021, 24.2.2022, 6.5.2022, 20.6.2022, 16.9.2022, 21.9.2022, 28.9.2022 dhe 6.12.2022; vendim për caktim seance gjyqësore të datave 5.3.2020, 7.4.2020, 17.7.2020, 26.4.2021, 15.7.2021, 18.10.2022, 28.10.2022 dhe 11.11.2022.

të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Antonela Prendi:

i) Ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal, të cilat konsiderohen si pasaktësi që nuk kanë pasur për qëllim fshehje pasurie apo deklaram të rremë.

i/1) Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti kanë ka pasur mungesë burimesh financiare në momentin e krijimit të pasurive në shumën 644,269 lekë dhe ka rezultuar me balancë negative për vitin 2007 në shumën 152,752 lekë dhe në vitin 2015 në shumën 256,542 lekë për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara.

i/2) Komisioni, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, i udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, vlerëson se pasaktësitë e konstatuara, si dhe mungesa e burimeve të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për të justifikuar shpenzimet dhe krijimin e pasurive, nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësia.

i/3) Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Antonela Prendi ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

ii) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Antonela Prendi ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

iii) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “e aftë”, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Antonela Prendi, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 27.1.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Xhensila PINE**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*